Nr. 651 Prot.
dt 01/04/16

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr 2410 Prot | Elbasan, më 31 .03.2016

VENDIM

Nr. 518 datë 31 .03.2016

Për

"EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË AKSIONARE "UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN" sh.a.

Në mbështetje të nenit 135, pika 2(c) të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, në zbatim të kërkesave të nenit 5, pika 1(b), nenit 7, pika "dh" dhe nenit 12 të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., sipas rendit të ditës të parashikuar në njoftimin e bërë me shkresën nr.365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e datës 31.03.2016,

VENDOSI

1. Të emërohen anëtarë te Këshillit të Administrimit të shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime Elbasan" sha, e organizuar sipas sistemit me një nivel administrimi, personat e mëposhtëm:

   z.Klevis XHOXHI - me profesion jurist.
   zj.Elena XHINA - me profesion juriste.
   z.Florjan XHEMALAJ - me profesion jurist.

2. Personat e mësipërm emërohen si anëtarë të Këshillit të Administrimit të shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime Elbasan" sha, për një mandat 3-vjeçar.
3. Midis Asamblesë së Përgjithshme dhe Anëtarëve të Këshillit të Administrimit të lidhen kontrata pune.
4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të shpërblehen sipas përcaktimeve të programeve ekonomike, që miratohen çdo vit.
5. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA ELBASAN

Nr 648 Prot
01/04/16

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr 2409 Prot | Elbasan më 31 .03.2016

VENDIM

Nr. 517 datë 31 .03.2016

Për

"PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKQYRËS DHE TË SEKRETARES SË KËSHILLIT MBIKQYRËS"

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr. 50, date 24.06.2014 "Mbi transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që kanë qënë në përdorim të shoqërisë "Elber" shpk, në pronësi të bashkisë Elbasan", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha, nenit 135, pika 2(b) të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të nenit 135/2, pika "c" dhe nenit 11 të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shkresës nr.365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, si dhe rendit të ditës të parashikuar në këtë njoftim, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha. në mbledhjen e datës 31.03.2016,

VENDOSI

1. Të miratojë lirimin nga detyra të Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sh.a., si pasojë e riorganizimit ligjor të shoqërisë sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", të publikuar në Fletoren Zyrtare nr.11/2016:
   - Z. Irland SINA;
   - Z. Qemal TUSHA;
   - Z. Klevis XHOXHI;
   - Z. Ilirjan BALLIU;
   - Z. Arben XHINA;
   - Z. Klajd GRIPSHI.
2. Të miratojë lirimin nga detyra të Sekretares të Këshillit Mbikqyrës Znj.Alisa Isaj, si pasojë e riorganizimit ligjor të shoqërisë sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", të publikuar në Fletoren Zyrtare nr.11/2016.
3. Personat e lartpërmnëdur me përfundimin e detyrës duhet të shlyejnë detyrimet që kanë ndaj shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sha., sipas urdhëresës së Kontrollit të Lartë të Shtetit.
4. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

Nr 650 Prot
01/04/16

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr____Prot | Elbasan, më 31 .03.2016

VENDIM

Nr.521 datë 31 .03.2016

Për

"EMËRIMIN E SEKRETARIT TË ASAMBLESË TË SHOQËRISË AKSIONARE "UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN" sh.a.

Në mbështetje të nenit 135, pika 2(j) të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr. 104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, në zbatim të kërkesave të nenit 5, pika 1(b), nenit 7, pika "dh" dhe nenit 12 të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., sipas rendit të ditës të parashikuar në njoftimin e bërë me shkresën nr. 365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e datës 31.03.2016,

VENDOSI

1. Të emërojë Sekretar të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sh.a. Zj.Alisa Isaj.
2. Sekretari i Asamblesë së Përgjithshme është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon kryetari i AP-së.
3. Sekretari i Asamblesë së Përgjithshme do të shpërblehet sipas përcaktimeve të programeve ekonomike, që miratohen çdo vit.
4. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

Nr 652 Prot
dt 01/04/16

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr 2411 Prot | Elbasan, më 31 .03.2016

VENDIM

Nr. 519, datë 31 .03.2016

Për

"PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË UJËSJELLËS – KANALIZIME ELBASAN sh.a."

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.50, date 24.06.2014 "Mbi transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që kanë qënë në përdorim të shoqërisë "Elber" shpk, në pronësi të bashkisë Elbasan", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha, nenit 135, pika 2(b) të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të nenit 135/2, pika "c" dhe nenit 11 të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shkresës nr.365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, si dhe rendit të ditës të parashikuar në këtë njoftim, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e datës 31.03.2016,

VENDOSI

1. Të miratojë lirimin nga detyra të Administratorit të shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sh.a. **Z.Elsid Zyma**, si pasojë e riorganizimit ligjor të shoqërisë sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".
2. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 04.04.2016.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

Nr 653 Prot.
dt 01/04/16

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr 2412 Prot | Elbasan, më 31 .03.2016

VENDIM

Nr. 520 datë 31 .03.2016

Për

"PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË AKSIONARE "UJËSJELLËS - KANALIZIME ELBASAN" sh.a.

Në mbështetje të nenit 135, pika 2(c) të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha, në zbatim të kërkesave të nenit 7, pika "dh" dhe nenit 18 të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., sipas rendit të ditës të parashikuar në njoftimin e bërë me shkresën nr.365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e datës 31.03.2016.

VENDOSI

1. Të emërojë në detyrë si Administrator i shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime Elbasan" sha., e organizuar sipas sistemit me një nivel administrimi, **z. Florjan XHEMALAJ**.
2. Administratori të emërohet për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Midis administratorit dhe Asamblesë së Përgjithshme të lidhet kontrata vjetore. Rinovimi i kontratës midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës së administratorit.
4. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 04.04.2016.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

Nr 649 Prot
01/04/16.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr 2408 Prot | Elbasan, më 31 .03.2016

VENDIM

Nr. 516, datë 31.03.2016

Për

"MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË AKSIONARE "UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN"

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.50, date 24.06.2014 "Mbi transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që kanë qënë në përdorim të shoqërisë "Elber" shpk, në pronësi të bashkisë Elbasan", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, nenit 135, pika 2(b) të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të nenit 9, pika "b" dhe nenit 25 të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shkresës nr.365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, si dhe rendit të ditës të parashikuar në këtë njoftim, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e datës 31.03.2016,

VENDOSI

1. Të miratojë Statutin e shoqërisë tregtare "Ujësjellës-Kanalizime Elbasan" sha (shkurt "UKE" sha), sipas Statutit tip të miratuar me VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", të publikuar në Fletoren Zyrtare nr.11/2016.
2. Statuti i shoqërisë tregtare "Ujësjellës-Kanalizime Elbasan" sha të jetë ai bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

Nr 647 Prot
01/04/16

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr____Prot | Elbasan, më 31 .03.2016

VENDIM

Nr. 514, datë 31 .03.2016

Për

"RIORGANIZIMIN LIGJOR TË SHOQËRISË "UJËSJELLËS – KANALIZIME ELBASAN" sh.a."

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.50, date 24.06.2014 "Mbi transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që kanë qënë në përdorim të shoqërisë "Elber" shpk, në pronësi të bashkisë Elbasan", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, nenit 135, pika 2(b) të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të nenit 135/1, pika "h" dhe nenit 25 të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shkresës nr. 365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, si dhe rendit të ditës të parashikuar në këtë njoftim, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e datës 31.03.2016,

VENDOSI

1. Të miratojë riorganizimin ligjor të shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sh.a., nga shoqëri aksionere me dy nivele administrimi, në shoqëri aksionere me një nivel administrimi, sipas kërkesa ligjore të përcaktuara në VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", të publikuar në Fletoren Zyrtare nr.11/2016.
2. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

Nr 646 Prot
dt 01/04/16

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
(AKSIONARI I VETËM)

Nr____Prot | Elbasan, më 31 .03.2016

VENDIM

Nr. 515, datë 31 .03.2016

Për

"ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "UJËSJELLËS – KANALIZIME ELBASAN" sh.a."

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.50, date 24.06.2014 "Mbi transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, që kanë qënë në përdorim të shoqërisë "Elber" shpk, në pronësi të bashkisë Elbasan", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Elbasan nr.104, datë 24.12.2015 "Për autorizimin për përfaqësimin e aksionarit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, nenit 135, pika 2(b) të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të nenit 177 - 179 dhe të Statutit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha., të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shkresës nr.365 prot, datë 17.02.2016 "Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha" të administratorit të shoqërisë "UKE" sha, si dhe rendit të ditës të parashikuar në këtë njoftim, Asambleja e Përgjithshme (Aksionari i Vetëm) i shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e datës 31.03.2016,

VENDOSI

1. Të bëhet zmadhimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë me anë të përfshirjes në kapital të kontributeve në natyrë të dhëna nga Aksioneri Vetëm.
2. Vlera e kapitalit të regjistruar pas zmadhimit bëhet 1.568.118.300 Lekë.
3. Numri i aksioneve të kapitalit pas zmadhimit behet 15.681.183 aksione.
4. Vlera nominale e një aksioni pas zmadhimit të kapitalit bëhet 100 Lekë.
5. Aprovohet raporti i eksperteve kontabël të autorizuar Z.Agim Qenani dhe Znj.Nexhmije Çela për zmadhimin e kapitalit.
6. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AKSIONARI I VETËM)
e përfaqësuar
KRYETARI I BASHKISË ELBASAN
Qazim SEJDINI

Nr. 1785/1 Prot. 29.3.2016

BASHKIA ELBASAN

Nr. 6438/1 Prot | Elbasan më 29/03/2016

VENDIM

Nr. 1156/1, Datë 29/03/2016

"Për emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për shlyerjen e kapitalit dhe zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sh.a."

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008. "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 135, në ligjin nr. 8658, datë 31.07.2000. "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 44, si përfaqsues i aksionerit të vetëm të Shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sh.a., me autorizimin e dhënë nga Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 14, datë 19.02.2015. "Për autorizimin për përfaqsimin e aksionerit të vetëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sh.a.",

VENDOSA:

1. Të emëroj Ekspert Kontabël të Autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërise "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sh.a., për shlyerjen dhe zmadhimin e kapitalit të shoqërisë:
   - Z. Agim QENANI;
   - Znj. Nexhmije ÇELA.
2. Ky vendim të regjistrohet në regjistrin e Vendimeve të Asamblesë të shoqërisë "Ujësjellës – Kanalizime Elbasan" sh.a..
3. Ngarkohet Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
Qazim SEJDINI

UKE
Ujësjellës Kanalizime Elbasan

Lagja Brigada 17 Sulmuese
Telefon +355 54 242 054
Telefax +355 54 240 755
Email ukelbasan@gmail.com

Nr 642 Prot | Elbasan, më 31.03.2016.

Per : Qendren Kombetare te Regjistrimeve

ELBASAN

LENDA : Deklarim per gjendjen e aktiveve me date 31.03.2016.

Une i nenshkruari Elsid Zyma, ne funksionin tim si administrator e shoqerise «UKE» sh.a., deklaroj nen pegjegjesine time personale si vijon :
Gjendja e aktiveve neto te shoqerise me date 31.03.2016, date ne te cilen eshte mbledhur asambleja e aksionereve te shoqerise, ku ka marre vendim per zmadhimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise duke perdorur kontributet ne natyre te ortakut sipas bilancit te date 31.12.2014, eshte e tille qe, nese vendimi per zmadhim te kapitalit do te ishte marre ne daten e aplikimit prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, zmadhimi do te ishte i mundur.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
UJËSJELLËS - KANALIZIME ELBASAN sh.a.
Elsid ZYMA

AGIM QENANI
NEXHMIJE CELA

EKSPERTE KONTABEL TE REGJISTRUAR
Licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR

Mbi Pasqyrat Financiare per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise:
«Ujsjelles Kanalizime » sha Elbasan

Per periudhen
Janar - Dhjetor 2014

RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR PER KONTROLLIN E OPERACIONEVE TE KRYERA PER ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE "UJSJELLES-KANALIZIME"SH.A. ELBASAN

Drejtuar. Asamblese se Pergjitheshme te Shoqerise
Keshillit Mbikqyres
Administratorit te shoqerise

Te nderuar zoterinj,

Duke ju falenderuar per besimin e dhene per kryerjen e misonin tone te pavarur per dhenien e sigurise ne kemi nderin t'ju raportojme ne lidhje me kontrollin e operacionit te zmadhimit te kapitalit te shoqerise "Ujesjelles Kanaizime"sha Elbasan, i cili eshte rezultat i transferimit te aktivitetit te shoqerise ELBER sh.p.k. ne shoqerine „Ujsjelles Kanalizime" sha Elbasan.

Përgjegjësia e paleve për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqerise është përgjegjës për përgatitjen e vërtetë dhe të sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshem te raportimit financiar qe perfshin Ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardet Kombëtare te Kontabilitetit dhe,dhe për kontrollet e brendshme që drejtimi i konsideron te nevojshme për pregatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajne anomali materiale, qoftë nga gabimi apo mashtrimi

Përgatitja e pasqyrave financiare perkatese te shoqerise ne te cilen transferimi i Aktiveve neto qe i perkasin *ELBER sh.p.k.*ne administrim te bashkise është përgjegjësi Juaja për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre veprimeve financiare në përputhje me legjislacionin ne fuqi.
Përfaqësuesit ligjorë dhe financiarë të Shoqërisë "Ujesjelles Kanaizime"sha Elbasan qe janë angazhuar dhe kane pergatitur pasqyrat financiare te shoqërisë sipas akteve perkatese ligjore ne fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia e Eksperteve Kontabel të Autorizuar është të formojne një opinion të pavarur mbi këto pasqyra, bazuar në punen e kryer.
Ne kemi kryer angazhimin në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që per kryerjen e ketij angazhimi të planifikohen dhe të zbatohen procedura për të dhene siguri të arsyeshme që zmadhimi i kapitalit te shoqerise eshte kryer ne perputhje te plote me rregullat e zbatueshme dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit dhe legjislacionin ne fuqi.
Angazhimi përfshin procedura për të marre evidence për vlerat dhe paraqitjen e tyre ne pasqyrat financiare mbi bazen e testimeve të dokumentave që mbështesin shifrat dhe informacionet e tjera të pasqyrave financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditusesit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut te ekzistences së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

- Misioni i dhene nga Ju eshte bazuar ne Vendimi i KB Nr.1156, date 16.11.2015"Per emerimin e EKA per shlyerjen e kapitalit dhe zmadhimin e kapitalit te shoqerise ujesjelles-kanalizime Elbasan sh.a."; Pasqyrat financiare te shoqerise "Ujesjelles Kanalizimet" sha Elbasan te miratuar te dates 31.12.2014 , Procesverbalet e dorezimit te aktiveve dhe detyrimeve te mbajtura midis Administratoreve te Shoqerise " Ujesjelles Kanalizimet" sha Elbasan dhe Shoqerise ELBER sh.p.k.

a) Baza Ligjore

- Ligjit Nr. 8652, date 31.07.2000, "Per organizimin dhe funksionimin e organeve te Qeverisje Vendore", i ndryshuar
- Ligji Nr. 115/2014 datë 31.7.2014 Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë
- Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9228 dt. 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar
- Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",
- VKM Nr.271,date 08.05.1998 "Per miratimin e statutut TIP te Shoqerive Anonime Shteterore",
- VKM Nr.351, date 04.06.2014"Permiratimin e listes se inventarit te pasurive te paluajtshme shteterore te sistemit ujsjelles kanalizime, ne perdorim te shoqerise ELPER sh.p.k".
- Vendimi i KB Nr. 73, date 18.09.2014 " Per kalimin ne pronesi te pronave te fituara sipas VKM Nr. 351, date 04.06.2014".
- Vendimi i KB Nr.50, date 24.06.2014 "Mbi transferimin e pronave te paluajtshme shtetrore , qe kane qene ne perdorim te shoqerise ELPER sh.p.k., Elbasan ne pronesi te bashkise Elbasan. "
- Vendimi i KB Nr.1156, date 16.11.2015"Per emerimin e EKA per shlyerjen e kapitalit dhe zmadhimin e kapitalit te shoqerise ujsjelles-kanalizime Elbasan sh.a."

b) Afati mbi te cilen shtrihet raporti i dhenies se sigurise se pavarur

Me poshte po paraqesim bazen mbi te cilen eshte vepruar per perfundimin e procesit te zvogelimit te kapitalit te shoqerise

✓ *Baza e te dhenave mbi te ciiin u mbeshtet procesi i zvogelimit te kapitalit te shoqerise jane Pasqyrat Financiare 31.12.2014 (bashkengjitur)*
✓ *Veprimet /Ngjarjet e ndodhura gjate procesi i zmadhimit te kapitalit te shoqerise per periudhen 2014*
✓ *Vendimet e Asamblese te shoqerise*

c) Identifikimi i paleve ne proces

Shoqëria "Ujesjelles Kanalizime"sha , Elbasan e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L 43121201L , me seli në adresën Lagjja Brigade e 17 Sulmuese, Rruga Petraq Popa, Zk 8523, pasuria nr 4/40, Elbasan, eshte nje shoqeri aksionere krijuar nga Bashkia Elbasan, e përfaqësuar nga Administratori z. Elsid Zyma, dhe me objekt te veprimtarise : *Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirmbajtja e sistemit /eve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe / ose blerja e ujit per plotesimine kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit , largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura dhe shitjae tij .Mirembajtaja e sistemeve te ujerave te ndotura si dhe te impjanteve te pastrimit te tyre.*

d) Trajtimi kontabel i zmadhimit te kapitalit te shoqerise

Shoqeria "Ujesjelles- Kanalizime" sha, Elbasan eshte regjistruar si shoqeri ne QKR daten 21.07.2014 me kapital themeltar prej **3.500.000** leke , i ndare ne 35.000 aksione me vlere nominale 100 leke secila.*(Extrati historik i QKR-se). Sipas bilancit te vitit ushtrimor 2014 kapitali i themelimit nuk eshte paguar nga ortaku i vetem.*
Me Vendimi i KB Nr.1156, date 16.11.2015"Per emerimin e EKA per shlyerjen e kapitalit dhe zmadhimin e kapitalit te shoqerise ujsjelles-kanalizime Elbasan sh.a."eshte vendosur zmadhimi i kapitalit te shoqerise ne masen prej 1.568.118.300 leke dhe kapitali themeltar i shoqerise behet **1.571.618.300** leke
Nga ana tjeter meqenese nuk eshte paguar kapitali fillestar per shumen prej 3.500.000 leke, behet njekohesisht edhe zvoglimi i kapitalit per kete shume dhe perfundimisht kapitali i shoqerise pas zmadhimit behet 1.568.118.300 leke
Bazuar ne

- Vendimi i KB Nr. 73, date 18.09.2014 " Per kalimin ne pronesi te pronave te fituara sipas VKM Nr. 351, date 04.06.2014".
- Vendimi i KB Nr.50, date 24.06.2014 "Mbi transferimin e pronave te paluajtshme shtetrore , qe kane qene ne perdorim te shoqerise ELPER sh.p.k., Elbasan ne pronesi te bashkise Elbasan. "

Se pari jane trasferuar prane shoqerise "Ujesjelles- Kanalizime" sha Asetet dhe detyrimet qe ishin ne perdorim te shoqerise ELPER sh.p.k. sipas pasqyres se meposhteme

Llogaria	Emertimi	Debi	Kredi
212	Ndertesa	163,782,868.00	
21271	Rrjeti i Shperndarjes ujit Ndertime	1,010,301,856.00	
21271	Rrjeti i Shperndarjes ujit Ndertime	2,575,218.00	
21272	Rrjeti i shperndarjes kanalizime Ndertime	138,171,412.00	
21301	Makineri Paisje Pune energjitike	58,011,592.00	
2151	Mjete transporti	19,245,727.00	
2181	Mobilje dhe pajisje zyre	4,621,236.00	
35	Mallra	1,100.00	
372	Materiale te tjera		2,000.00
40100	Furnitore te tjere		855,812.00
40101	CEZ Shperndarje Sha		532,346.00
40104	VODAFON SH.A		80,695.00
40105	EDI SERVIS SH.P.K		309,963.00
40106	2 AT Shpk		59,052.00
40107	SALILLARI SH.P.K		35,362.00
40108	Eagle Mobile		45,606.00
40110	Krijon Shpk		458,100.00
40112	SGS Automotive Albania		2,010.00
40114	Bajrami-N Shpk		5,180,238.00
40115	SIGAL SHA		236,003.00
40117	Fillati Postes		1,626.00
40118	Colombo Shpk		548,000.00
401202	Hastoçi sh.p.k.		74,355.00
401205	INA SHPK		18,500.00
401210	Leonora Pacili		72,000.00
401214	IMAG sh.p.k.		23,501.00
401217	Holti Cani		32,640.00
401219	Aldo Gjavori	48,003.00	
40126	Agron Manaj		42,735.00
40130	Info Soft Office Shpk		180,946.00
40133	Sigurakon Mjetesh	10,150.00	
40137	A & V OIL SHPK		618,439.00
40138	IMS Instituti Modelimeve Sianes		154,000.00
40145	D.P.SH.T.RR.		24,240.00
40147	Insig Sha		172,040.00
40189	Avokat,Notere,Permbyes		72,000.00
40193	Ergi Shpk		3,449,333.00
40199	DELFI SH.P.K.		190,355.00
41100	Kliente per shitje uji	173,176,555.00	
41102	BELADI SHPK		750,000.00
41103	Drejtoria Rajonale Arsimore	580,295.00	
41104	Kliente per lidhje rrjedhje KUZ		54,500.00
4111	Kliente per lidhje,rrjedhje		1,328,730.00
41111	Shitje-Kliente per lidhje,rrjedhje uji	70,216.00	
41112	Kliente per prerje uji		470,742.00
411121	Shitje-Kliente per prerje uji	1,257,342.00	
41113	Kliente per rivulosje		112,320.00
411131	Shitje-Klienete per rivulosje	231,720.00	
4112	Ministri Planvendosje	321,180.00	
4113	Kliente per vendosje kontatori		1,573,700.00
41131	Shitje-Kliente per venie matesi	3,957,654.00	
4114	Kliente per sherbime te ndryshme		10,000.00
4116	Kliente per tarifa	261,950.00	
46711	Takse permbarimore	57,240.00	
46721	Raporte,pene invaliditet	531,300.00	
46734	Fatmir Marani	500,000.00	
46741	Arketimet nga posta	3,251,019.00	
46742	Arketimet nga qendra klientave		3,649,676.00
46745	Fetah Canka,fatura leke	650,227.00	
4911	Zhvleresim per kl. mall,prod.		77,372,998.00
531102	Arka Elber ALL	1,838,763.00	
	Totali:	**1,583,444,739**	**98,792,720**
	Aktivet neto	1,484,652,019	

Se dyti pervec aktiveve neto si pas tabeles se mesiperme Shoqeria ka marre ne perdorim pronen e shtetit qe quhet aktivet e ujsjellesit te vjeter i cili ka nje vlere prej 81.924.505 leke, qe ne pasqyrat financiare te shoqerise Elber ka qene ne llogarite jashte bilancit.
Se treti shoqeria ka marre fonde te pakthyeshme per fillimin e aktivitetit nga Shoqeria Elber shpk ne shumen prej 13.541.824 leke.

Perfundimisht te tre shumat e trajtuara nme siper qe ne total zene 1.568.118.348 leke nga te cilat do tee perdoren nga shoqeria per zmadhimin e kapitalit te regjistruar 1.568.118.300 leke.

Bazuar ne VKB e mesiperme dhe te PF te vitit 2014 shoqeria ka rregjistruar ne kontabilitetin e vet veprimet kontable te meposhteme, ku eshte perfituar dhe bilanci i dates 31.12.2014

➢ Veprimet e transferimit jane reflektuar mbi te dhenat e PF te shoqerise ne vitin 2014

Ne permbushje te misionit tone, nepermjet verifikimeve te bera , kostatojme se ne bilancin e shoqerise eshte pasqyruar ne rubrikat/postet "Rezerva te tjera", "Fitime te ushtrimit" shumat perkatese sipas miratimit te bilancit nga Asambleja e Pergjithshme e shoqerise.

Primi i aksionit, pasqyruar ne vleren 1,568,118,348.00leke para operacionit te zmadhimit te kapitalit, pas ketij operacioni pasqyrohet ne vleren 48 leke, pasi shuma prej 1,568,118,300.00leke leke eshte perfshire ne rritje te kapitalit aksioner sipas vendimit te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise.

Fitimi ushtrimor 2014 i shoqerise , i cili eshte i pasqyruar ne postin perkates "Fitime te ushtrimit" , ne bilancin e datës 31.12.2014 eshte ne vleren 1,637,751.00leke, ngelet po i njejte.

Me vlerat e mesiperme 1.568.118.300 leke eshte bere zmadhimi i Kapitalit Aksioner te shoqerise, dhe pas ketij operacioni situata paraqitet si vijon :

	Pasqyra e Kapitalit te shoqerise	Viti 2014 para zmadhimit te kapitalit	Viti 2014 pas zmadhimit te kapitalit
	KAPITALI	1,573,256,099.00	1,569,756,099.00
1	Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)		
2	Kapitali aksionereve te shoq.meme (PF te kons.)		
3	Kapitali aksionar	3,500,000.00	1,568,118,300.00
4	Primi aksionit	1,568,118,348.00	48.00
5	Njesite ose aksionet e thesarit		
6	Rezervat statutore		
7	Rezervat ligjore		
8	Rezervat e tjera		
9	Fitimet e pa shperndara		
10	Fitimi (Humbja) e vitit financiar	1,637,751.00	1,637,751.00

Paraqitja e kapitalit Aksioner te shoqerise"Ujesjelles – Kanalizime" sha Elbasan eshte si meposhte :

AKSIONERET	ISHTE Numri Aksioneve	ISHTE % pjesmarrjes	ISHTE Vlera e Kap. Aksionere	BEHET Numri Aksioneve	BEHET % pjesmarrjes	BEHET Vlera e Kap. Aksionere
BASHKIA Elbasan	35.000	100	3.500.000	15.681.183	100	1.568.118.300
TOTALI	35.000	100	3.500.000	15.681.183	100	1.568.118.300

Pas pasqyrimit te ketij operacioni zmadhimi te kapitalit aksioner , kapitali aksioner i shoqerise nga 3.500.000 leke, ndare ne nga 35.000 aksione me vlere nominale sejcili aksion 100,00 leke, te cilet zotrohen ne masen 100% nga Bashkia Elbasan, behet 1.568.118.300 leke, ndare ne nga 15.681.183 aksione me vlere nominale sejcili aksion 100,00 leke, te cilet zotrohen ne masen 100% nga Bashkia Elbasan.
Ne perfundim te misionit te kontrollit te ketij operacioni shprehim opinionin se bilanci kontabel i shoqerise "Ujesjelles- Kanalizimet" sha Elbasan pas ndryshimeve qe jane bere ne kapitalin aksioner, jep nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes pasurore, te rezultateve te veprimtarise dhe te situates financiare te shoqerise me daten 31.12.2014.
Ketij raporti i bashkengjitet bilanci vjetor i shoqerise me daten 31.12.2014 para dhe pas pasqyrimit te operacionit te Zmadhimit te kapitalit themeltar te nenshkruar.

Elbasan, me 18.03.2016
Eksperte Kontabël e Regjistruar (EKR/CPA)

Nexhmije Çela, EKR
Licence nr. 84 date 10.01.2001
Ortak Angazhimi në EuroKonsult sh.p.k
Rr. Brigada 8, P.9/1, Ap 14, Tirane

Agim Qenani, EKR
Licence IEKA nr 53 date 15.01.2000
Hotel Skampa Elbasan

AGIM QENANI

Emri i njesise "Ujesjelles Kanalizme Elbasan" sh.a
NIPT L 43121201 L
Adresa e selise Lagjja Dyli Bashiri, rruga "A.Sucelhen", ndertesa nr.12 ELBASAN

Data e krijimit : 21/07/2014
Nr. i Regjistrit tregtar : 243481

Veprimtaria Kryesore : Furnizim me uje te pijshem dhe largim i ujrave te zeza

PASQYRAT FINANCIARE

STATUSI JURIDIK : SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr. 3)

VITI 2014

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Leke
Pasqyrat Financiare jane te rrumbullakosura ne Leke

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare Nga 01.01.2014 Deri 31.12.2014

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 31.03.2015

	BILANCI	VITI 2014 ushtrimor	VITI 2014 ushtrimor	Diferenca
	AKTIVET			
I	AKTIVET AFATSHKURTERA			
1	Aktivet monetare	26,440,711		26,440,711
2	Derivative dhe aktive financiare te mbajtura per tregtim			0
3	Aktive te tjera financiare afatshkurtera	117,564,565	0	117,564,565
	Llogari/Kerkesa te arketueshme	92,131,064		92,131,064
	Llogari/Kerkesa te tjera te arket.	25,356,221		25,356,221
	Investime te tjera financiare	77,280		77,280
4	Inventari	76,325,834		76,325,834
	Lende e pare	76,325,834		76,325,834
	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)	220,331,110		220,331,110
II	AKTIVET AFATGJATA			
2	Aktive afatgjata materiale	1,529,995,897	0	1,529,995,897
	Toka	73,394,453		73,394,453
	Makineri dhe pajisje	67,557,509		67,557,509
	Aktive te tjera afatgjata materiale (me vlere kontabel)	1,389,043,935		1,389,043,935
5	Kapital aksionar i papaguar	3,500,000		3,500,000
	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)	1,533,495,897	0	1,533,495,897
	TOTALI I AKTIVEVE (I+II)	1,753,827,007	0	1,753,827,007

	BILANCI	VITI 2014 ushtrimor	VITI 2014 ushtrimor	Diferenca
	PASIVET DHE KAPITALI			
I	PASIVET AFATSHKURTERA			
3	Huate dhe parapagimet	180,570,908	0	180,570,908
	Te pagueshme ndaj furnitoreve	178,345,071		178,345,071
	Te pagueshme ndaj punonjesve	173,627		173,627
	Detyrime tatimore	2,052,260		2,052,260
	Sigurime shoqerore	1,671,198		1,671,198
	Tatimi mbi te ardhurat	81,893		81,893
	TVSH	299,117		299,117
	TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)	180,570,908		180,570,908
II	PASIVET AFATGJATA			
	TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA (II)	0		0
	TOTALI I PASIVEVE (I+II)	180,570,908		180,570,908
III	KAPITALI			
3	Kapital aksionar	3,500,000		3,500,000
4	Primi i aksionit	1,568,118,348		1,568,118,348
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	1,637,751		1,637,751
	TOTALI I KAPITALIT (III)	1,573,256,099		1,573,256,099
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)	1,753,827,007		1,753,827,007

Shoqeria " Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sh.a
TE ARDHURAT E SHPENZIMET (formati 1)
Periudha: 01/01/2014 - 31/12/2014

	PASH (Formati 1)	31.12.2014	31.12.2014
1	Shitjet neto (701-708)	92,291,233	
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytez. (75-78)	7,002,511	
	Te ardhura nga subvencionet (732)	35,000,000	
4	Materialet e konsumuara (601-609)	(50,987,733)	
5	Kosto e punes	(29,655,256)	
	Pagat e personelit	(26,433,754)	
	Sigurimet shoqerore	(3,220,834)	
	Shpenzime per pagat	(23,884,189)	0
6	Amortizimi dhe zhvleresimet (68)	-20,709,670	
7	Furnizime, sherbime dhe shpenzime (61-62)	-7,540,680	
7.1	Tatime dhe taksa (63-64)	-7,259,862	
7.2	Shpenzime te tjera (65)	-77,349	
	Totali per shpenzimet e tjera 7.1-7.4	(15,287,792)	0
8	Totali i shpenzimeve	(110,259,293)	0
9	Fitimi nga fushat e veprimtarise kryesore 1+2-3-8	1,934,449	0
	Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	2,420	0
13	Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	2,420	0
14	Fitimi (Humbja) para tatimit 9+13	1,936,869	0
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	(299,118)	0
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	1,637,751	0

Shoqeria " Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sh.a
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE (METODA INDIREKT)

Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit	31/12/2014	31/12/2013
Fitimi para tatimit	1,936,869	
Rregullime per:		
Amortizimin	20,709,670	
Rritje / renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	(117,564,565)	
Rritje / renie ne tepricen e inventarit	(76,325,834)	
Rritje / renie ne tepricen e detyrimeve, per tu paguar nga aktiviteti	180,570,908	
Tatimfitimi i paguar	(299,118)	
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytezimit		9,027,930
Fluksi i parave nga veprimtarite investuese		
Blerja e shoqerise se kontrolluar X minus paraja e arketuar	(1,550,705,567)	
Paraja neto e perdorur ne aktivitetet investuese		(1,550,705,567)
Fluksi i parave nga veprimtarite financiare		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar	1,568,118,348	
Paraja neto e perdorur ne aktivitetet financiare		1,568,118,348
Rritja / renia neto e mjeteve monetare	26,440,711	
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel		
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	26,440,711	

Pasqyra e levizjeve ne kapitalin e shoqerise "Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sh.a

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime
Elbasan Sh.A
NIPT L43121201L

Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka		0	0	0	0
2	Rrjeti Shperndarjes		1,012,877,074	90,770,558		1,103,647,632
3	Rrjeti Kanalizimeve		138,171,412			138,171,412
4	Ndertime		163,782,868	4,660,985		168,443,853
5	Makineri,paisje,vegla		58,011,592			58,011,592
6	Mjete transporti		19,245,727			19,245,727
7	Paisje zyre & kompjuterike		4,621,236	58,564,115		63,185,351
	TOTALI		1,396,709,909	153,995,658	0	1,550,705,567

Amortizimi A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka			0		0
2	Rrjeti Shperndarjes			12,783,548		12,783,548
3	Rrjeti Kanalizimeve			1,727,143		1,727,143
4	Ndertime			2,047,286		2,047,286
5	Makineri,paisje,vegla			2,900,580		2,900,580
6	Mjete transporti			962,286		962,286
7	Paisje zyre & kompjuterike			288,827		288,827
	TOTALI		0	20,709,670	0	20,709,670

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Toka		0	0	0	0
2	Rrjeti Shperndarjes		1,012,877,074	90,770,558	12,783,548	1,090,864,084
3	Rrjeti Kanalizimeve		138,171,412	0	1,727,143	136,444,269
4	Ndertime		163,782,868	4,660,985	2,047,286	166,396,567
5	Makineri,paisje,vegla		58,011,592	0	2,900,580	55,111,012
6	Mjete transporti		19,245,727	0	962,286	18,283,441
7	Paisje zyre & kompjuterike		4,621,236	58,564,115	288,827	62,896,524
	TOTALI		1,396,709,909	153,995,658	20,709,670	1,529,995,897

DREJTORI PERGJITHSHEM
UJESJELLES KANALIZIME ELBASAN SH.A
ALTIN CENOLLI

Shoqeria Ujesjelles Kanalizime
Elbasan Sh.A
NIPT L43121201L

Inventari i mjeteve te transportit ne pronesi te shoqerise "Ujesjelles Kanalizme Elbasan"Sh.A

Nr	Targa	Lloji	Tipi	Numri i Shasise	Viti i prodhimit	Ngjyra
1	EL 1913 B	Furgon	Wolksvagen	W V 2 ZZZ 70 ZXH 150480	1999	Bardhe
2	EL 1914 B	Furgon	Wolksvagen	W V 2 ZZZ 70 ZWH 004949	1997	Bardhe
3	EL 1915 B	Furgon	Wolksvagen	W V 2 ZZZ 70 ZVX 074075	1997	Bardhe
4	EL 1916 B	Furgon	Wolksvagen	W V 2 ZZZ 70 ZWX 061234	1998	Bardhe
5	EL 1917 B	Furgon	Wolksvagen	W V 2 ZZZ 70 ZVX 015357	1999	Bardhe
6	EL 1918 B	Furgon	Wolksvagen	W V 2 ZZZ 70 ZVX 074018	1997	Bardhe
7	EL 7088 A	Furgon	Benz Mercedes	W D B 60 93 621 NO 16019	1993	Blu
8	EL 0569 A	Furgon	Iveco	ZCFD 4079205109261	1996	Verdhe
9	EL 1991 B	Kamion	Benz Mercedes	W D B 67401315592485	1991	Bardhe
10	EL 1996 B	Kamion	Benz Mercedes	W D B 6740181K151749	1995	Bardhe
11	EL 1997 B	Kamion	Benz Mercedes	W D B 9700251K255447	1998	Bardhe
12	EL 1998 B	Kamion	Benz Mercedes	W D B 9700131 K 516409	1998	Bardhe
13	EL 2000 B	Kamion	Benz Mercedes	W D B 9520731K235283	1998	Bardhe
14	EL 4716 B	Ekskavator	Atlas	324 M 37661	1992	Bardhe
15	AA 800 GG	Fuoristrade	BMW X5	5UXFA13532LP30057	2002	Gri
16	EL 1416 B	Autoveture	Benz Mercedes	W D B 1241851 F 193814	1991	Blu
17	EL 2996 A	Autoveture	Mitsubishi	J M B S N K 82 AHL 004021	1992	Blu
18	AA 654 JY	Autoveture	Benz Mercedes	W D B 2020181 A 421435	1996	Vishnje
19	AD 194	Motokarro	Shifeng	L7STBF24881G34951	2008	Blu
20	EL 3331 C	Eskavator	CAT	CAT0432DHJBL00296	2003	Verdhe
21	AA 621 EN	Autoveture	Citroen	VF7GCWJYBBX507051	2011	Bardhe
22	AA 622 EN	Autoveture	Citroen	VF7GCWJYBBX514315	2011	Bardhe
23	AA 623 EN	Autoveture	Citroen	VF7GCWJYBBX507246	2011	Bardhe
24	AA 624 EN	Autoveture	Citroen	VF7GCWJYBBX514314	2011	Bardhe
25	AA 625 EN	Autoveture	Citroen	VF7GCWJYBBX507045	2011	Bardhe
26	AA 705 GP	Autoveture	Ford	WF0JXXTTPJTY08905	2007	Bardhe
27	AA 075 HF	Autoveture	Nissan	JN1CGUD22U0049075	2001	Bardhe
28	AA 867 GP	Autoveture	Nissan	JN1CGUD22U0030071	1999	Bardhe
29		Ekskavator	Linde H25D			Verdhe

DREJTORI PERGJITHSHEM
UJESJELLES KANALIZIME ELBASAN SH.A
ALTIN CENOLLI

AGIM QENANI
ALI PISHA

EKSPERTE KONTABEL I REGJISTRUAR
Licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar
Elbasan - Shqiperi

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR

Mbi Pasqyrat Financiare te Shoqerise:
«Ujesjelles Kanalizime Elbasan» Sh.a.

Per periudhen
Janar - Dhjetor 2014

Lagja L.Garakuqi, Rr.11 Nentori, Nr.14, Tel. 05452289 e-mail: agimqenani@yahoo.it
mobil 069 20 97408

AGIM QENANI
ALI PISHA

EKSPERTE KONTABEL I REGJISTRUAR
Licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar
Elbasan - Shqiperi

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR
PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT USHTRIMOR 2014
SHOQERIA "UJESJELLES KANALIZIME ELBASAN" SH.A.

PER : Shoqerine "Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sh.a.
Zotit Altin Cenolli
Administrator

ELBASAN

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise „Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sh.a., qe perbehen nga bilanci kontabel i dates 31 dhjetor 2014, pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin e vet dhe pasqyra e fluksve te parase, per vitin e mbyllur ne ate date, dhe nje permbledhje e metodave te rendesishme kontabel dhe shenimeve te tjera anekse.

Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin, dhe mbajtjen e kontrollit te brendeshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare, pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtateshme kontabel, kryerjen e cmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Auditimi yne u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe te respektojme kerkesat e etikes dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te marrim nje siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale.

Auditimi ka te beje me kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire ketu edhe vleresimin e rreziqeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Kur vleresoin keto rreziqe, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendeshem te shoqerise mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare ne menyre qe te planifikoje procedura te pershtateshme auditimi ne rrethanat perkatese te shoqerise, por jo me qellim qe te shprehe nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendeshem te shoqerise. Auditimi gjithashtu ka te beje me vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe me vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtateshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Lagja L.Garakuqi, Rr.11 Nentori, Nr.14, Tel. 05452289 e-mail: agimqenani@yahoo.it
mobil 069 20 97408

AGIM QENANI
ALI PISHA

EKSPERTE KONTABEL I REGJISTRUAR
Licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar
Elbasan - Shqiperi

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te gjendjes financiare te shoqerise „Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sh.a. me date 31 dhjetor 2014, te rezultatit te saj financiar dhe te fluksit te se parave per vitin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Elbasan me 23.05.2015

EKSPERTI KONTABEL I REGJISTRUAR
AGIM QENANI ALI PISHA

Lagja L.Garakuqi, Rr.11 Nentori, Nr.14, Tel. 05452289 e-mail: agimqenani@yahoo.it
mobil 069 20 97408

AGIM QENANI

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR
Licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar nr 53
Elbasan - Shqiperi

LETER ANGAZHIMI PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TE VITIT USHTRIMOR 2014

PER : Shoqerine "Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sha
Administratorit te shoqerise Zotit Altin Cenolli

ELBASAN

Ju keni kerkuar qe ne te auditojme pasqyrat financiare te shoqerise "Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sha, per vitin ushtrimor 2014 te perbera nga bilanci, pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e fluksit te parase, pasqyra e levizjes se kapitalit dhe anekset. Kemi kenaqesine qe nepermjet kesaj letre tju konfirmojme pranimin dhe marrjen persiper te ketij angazhimi.

Auditimin do ta kryejme ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Ai do te behet me objektivin qe te shprehim nje opinion mbi pasqyrat financiare. Keto standarte kerkojne qe te planifikojme dhe te kryejme auditimin, per te dhene sigurine e aresyeshme nese pasqyrat financiare kane apo nuk kane anomali materiale. Auditimi perfshin vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe cmuarjet e rendesishme te bera nga drejtimi, sikunder dhe vleresimin per paraqitjen e pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Si rrjedhoje e natyres se testeve, dhe kufizimeve te tjera te vetvetishme te auditimit, sebashku me kufizimet e vetvetishme te sistemit kontabel dhe atij te kontrollit te brendeshem, egziston nje rrezik i pamenjanueshem qe perseri disa anomali materiale te mbeten pa zbuluar. Pervec raportit mbi pasqyrat financiare, parashikojme tju japim juve edhe nje leter te vecante, ne lidhje me ndonje dobesi materiale te sistemeve kontabel dhe te kontrollit te brendeshem te verejtur.

Ju kujtojme se pergjegjesia per pergatitjen e pasqyrave financiare, perfshire edhe paraqitjen e pershtateshme, eshte e Drejtimit te shoqerise. Kjo perfshin mbajtjen regjistrimeve te duhura kontabel dhe kontrollet e brendeshme, zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabel dhe ruajtjen e aktiveve te shoqerise. Si pjese perberese e procesit te auditimit, ne do te kerkojme nga drejtimi konfirmim me shkrim per deklarimet e bera ndaj nesh ne lidhje me auditimin. Pasqyrat financiare jane hartuar sipas kuadrit kontabel te parashikuar ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Lagja L.Garakuqi, Rr.11 Nentori, Nr.14, Tel. 05452289 e-mail: agimqenani@yahoo.it
mobil 069 20 97408

AGIM QENANI

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR
Licence profesionale nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar nr 53
Elbasan - Shqiperi

Shpresojme te kemi bashkepunim te plote me stafin tuaj dhe besojme se ata do te na vene ne dispozicion regjistrat, dokumentacionin dhe informacionin tjeter qe kerkohet per kryerjen e auditimit.
Kuotat tona te pageses, te cilat do te faturohen gjate ecurise se punes bazohen ne kohen e kerkuar ne kete angazhim, tabelen orare te miratuara qe varjojne sipas shkalles se pergjegjesise, eksperiences dhe pergatitjes profesionale qe kerkohet si dhe tarifat orare te pagesave te miratuara nga Ministri i Financave.
Konkretisht per kete auditim llogaritja e honorarave do te jete si vijon

Ore pune	160 ore
Tarifa orare (pa tvsh)	3.000 leke
Honorare gjithsejt (pa tvsh)	480.000 leke

Kjo leter do te jete e zbatueshme per vitet e ardheshme, duke perjashtuar rastet kur perfundon afati, kur amendohet, apo zevendesohet.
Ju lutemi firmoseni dhe na dergoni kopjen qe i bashkengjitet kesaj letre per te treguar se ajo eshte ne perputhje me kuptimin tuaj te marrveshjes per auditimin e pasqyrave financiare

Date 28.04.2015

Ekspertet kontabel te regjistruar
Agim Qenani Ali Pisha

Zotit Agim Qenani,
Jemi dakord me leteren e angazhimit per kryerjen e misionit te auditimit te pasqyrave financiare.

Administratori Altin Cenolli

Lagja L.Garakuqi, Rr.11 Nentori, Nr.14, Tel. 05452289 e-mail: agimqenani@yahoo.it
mobil 069 20 97408

KONTRATE

E lidhur sot me daten 28.04.2015 ndermjet Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime Elbasan"sha, te perfaqesuar nga Administratori zoti Altin Cenolli dhe ekspertevе kontabel te regjistruar Zotit Agim Qenani dhe Ali Pisha, mbi auditimin e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2014.

Objekti i kesaj kontrate eshte ekspertimi i llogarive vjetore me reference me dispozitat ne fuqi te cilat urdherojne dhe disiplinojne ekspertimin e llogarive.

Ne funksion te objektit te mesiperm palet marrin persiper te drejtat dhe detyrimet perkatese si vijon:

Shoqeria «Ujesjelles Kanalizime Elbasan» sha

- Te veje ne dispozicion te gjithe dokumentacionin kontabel te kerkuar nga eksperti per kryerjen e misionit te tij.
- Te veje ne dispozicion te gjithe procesverbalet e mbledhjeve dhe raportet perkatese te perpiluara nga subjekti.
- Te jape te gjitha shpjegimet e nevojshme te kerkuara nga eksperti per specifikat dhe problemet e ndryshme qe do te paraqiten.
- Te shlyeje pagesen ne perfundim te misionit ne reference me tabelen orare te percaktuar nga IEKA dhe tarifen orare te percaktuar nga BMP.
- Te kerkoje dorezimin e raporteve te ekspertimit ne perfundim te misionit te ekspertizes.

Eksperti kontabel

- Te kryeje ekspertizen e llogarive ne reference me normat profesionale.
- Te ruaje pavaresine profesionale ne gjykimin e dhenien e vleresimeve.
- Te ruaje sekretin profesional.
- Te kryeje misionin brenda afateve te percaktuara ne kontrate .
- Per probleme te vecanta shtese te plotesoje marreveshje shtese gjithnje ne plotesim te misionit.
- Te dorezoje ne perfundim te misionit raportin e ekspertizes te llogarive vjetore.

Afati i kryerjes se misionit

Afati i kryerjes se misionit te ekspertizes se llogarive vjetore do te jete deri me date 30.06.2015

ADMINISTRATORI
Altin Cenolli

EKSPERTET
Agim Qenani Ali Pisha

VENDIM
Nr.660, datë 12.9.2007

PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE DHE KANALIZIMEVE NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 1.II, shkronja "a", 10, pika 3.I, shkronjat "a" e "b", dhe 72, pika 5.I , shkronjat "a" e "b" të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të neneve 3, shkronja "e", 4, 6, shkronja "a", 7, 8 e 16, pika 1 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e aksioneve të shoqërive shtetërore të ujësjellësve dhe kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kur shoqëria e ujësjellësve dhe kanalizimeve mbulon më shumë se një njësi qeverisjeje vendore, bazuar në shitjen me pakicë, në marrëdhëniet tregtare me përdoruesit finalë, aksionet e shoqërisë, që transferohen, u kalojnë njësive të qeverisjes vendore përkatëse në bashkëpronësi, ku pjesa takuese e aksioneve të çdo njësie është në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë së asaj njësie, që mbulohet nga shoqëria e ujësjellësit dhe kanalizimeve.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve sipas këtij vendimi, janë të detyruara, që, për një periudhë kohore prej jo më pak se dy (2) vjetësh nga data e bërjes efektive të transferimit të aksioneve.

a) të mos shesin aksionet e tyre te persona, fizikë ose juridikë, të tjerë, shtetërorë a privatë;

b) të mos kryejnë ndarje të shoqërisë, por ta mbajnë atë si një njësi ligjore të vetme operuese.

4. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë prona sipas këtij vendimi, të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me ligjin nr.8744, datë 22.2.2001, të cilin e paraqet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

5. Detyrimet e prapambetura të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, deri në çastin e transferimit, sipas përcaktimeve të bëra në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të shlyhen nga Buxheti i Shtetit dhe bilancet e shoqërive, aksionet e të cilave transferohen, të zhvishen nga detyrimet e prapambetura përpara se të kryhet transferimi i aksioneve të tyre në njësitë e qeverisjes vendore.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme të dokumenteve ligjore dhe të udhëzuesve bazë, të nevojshëm (statuti i shoqërisë së transferuar dhe vendimit nr.642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikëqyrëse të shoqërive anonime shtetërore"), të cilët do të bëjnë të mundur rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpronësisë, ndërmjet njësive të qeverisjes vendore, si bashkëpronarë dhe të marrëdhënieve, ndërmjet këtyre të fundit me shoqëritë, që menaxhojnë sistemet e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të transferuara.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të programojë dhe të ndjekë zbatimin e udhëzimeve dhe të akteve nënligjore, për ngritjen e asambleve të ortakëve të njësive të qeverisjes vendore, bashkëpronarë të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, të transferuara sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Pika 3, e lidhjes 2, dhe pikat 1,3,4, sistemet 12 e 13, 5,6 e 7 të lidhjes 3 të vendimit nr.81, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore", pika 2 e lidhjes 3 të vendimit nr.173, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore", pikat 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9,10,11 e 12 të lidhjes 2 dhe pikat 1, 2, 3, 4, 5, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 e 21 të lidhjes 3 të vendimit nr.809, datë 26.11.2004 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore", si dhe vendimi nr.711, datë 18.10.2006, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore", shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA 1

Lista e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, aksionet e të cilave do të transferohen në njësitë e qeverisjes vendore (Nj.Q.V)

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit te listave te inventarit		Nr. Pasurisë	Njësitë e qeverisjes Vendore		
			Lista nr.___	VKM Nr.__, Date_____		Emri i Njësisë	Nr. Popullatës	% aksioneve për çdo Nj.Q.V
1	Ujësjellës Kraste	Sh.a		366,05.06.2003	2,735	Komunës Martanesh	2,735	100,0
2	Ujësjellës Selenice	Sh.a			7,012	Bashkisë Selenice	7,012	100,0
3	Ujësjellës Rubik	Sh.a	7	643,18.09.2003	8,059	Bashkisë Rubik	8,059	100,0
4	Ujësjellës Bilisht	Sh.a	7	366,05.06.2003	9,704	Bashkisë Bilisht	9,704	100,0
5	Ujësjellës Orikum	Sh.a			11,036	Bashkisë Orikum	11,036	100,0
6	Ujësjellës Poliçan	Sh.a	10	251,24.04.2003	12.164	Bashkisë Poliçan	9,530	78,3
						Komunës Bogovë	2,534	20,8
						Komunës Vendreshë	100	0,8
7	Ujësjellës Përmet	Sh.a	9	251,24.04.2003	13.830	Bashkisë Përmet	10,742	77,7
						Komunës Petran	3,088	22,3
8	Ujësjellës Has	Sh.a	20	366,05.06.2003	13.453	Bashkisë Krumë	7,705	57,3
						Komunës Fajza	4,201	31,2
						Komunës Gjinaj	1,547	11,5
9	Ujësjellës Kanalizime Peqin	Sh.a			14.138	Bashkisë Peqin	8,919	63,1
						Komunës Shezë	5,219	36,9

10	Ujësjellës kanalizime Mirdite	Sh.a			17.953	Bashkisë Rrëshen	14.253	79.4
						Komunës Selitë (pjesërisht	2.500	13.9
						Komunës Orosh (pjesërisht	1.200	6.7
11	Ujësjellës Bulqizë	Sh.a	1	251,24.04.2003	18.305	Bashkisë Bulqizë	13.913	76.0
						Komunës Shupenze (pjs)	4.392	24.0
12	Ujësjellës Kanalizime Librazhd	Sh.a	5	643,18.09.2003	19.187	Bashkisë Librazhd	10.123	52.8
						Bashkisë Përrenjas	8.264	43.1
						Komunes Qendër	600	3.1
						Komunës Rrajcë (pjeseri)	200	1.0
13	Ujësjellës Kanalizime Krujë	Sh.a	7	643,18.09.2003	19.514	Bashkise Krujë	15.789	80.9
						Komunës Cudhi	3.725	19.1
14	Ujësjellësi Skrapar	Sh.a	13	251,24.04.2003	23.599	Bashkisë Çorovodë	8.422	35.7
						Komunës Qendër	6.097	25.8
						Komunës Potom	1.310	5.6
						Komunës Çepan	1.515	6.4
						Komunës Gjerbës	1.817	7.7
						Komunës Vendreshë	100	0.4
						Komunës Bogovë	2.534	10.7
						Komunës Zhepë	1.804	7.6
15	Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë	Sh.a	12	251,24.04.2003	21.241	Bashkisë Rrogozhinë	11.123	52.4
						Komunës Gosë	8.124	38.2
						Komunës Sinaballaj	1.994	9.4
16	Ujësjellës Ura Vajgurore	Sh.a	6	366,05.06.2003	21,985	Bashkisë Ura Vajgurore	12.011	54,6
						Komunës Poshnjë	9.974	45.4
17	Ujësjellës Mat	Sh.a	1	643,18.09.2003	23.259	Bashkisë Burrel	18.195	78.2
						Komunës Lis	5.064	21,8
18	Ujësjellës Kanalizime Pukë	Sh.a	11	251,24.04.2003	23.430	Komunës Rrapë	2.652	11,3
						Komunës Qafe Mali	2.067	8.8
						Komunës Gjegjan	4.855	20,7
						Komunës Blerim	2.432	10.4
						Komunës Qelëz	2,639	11,3
						Komunës Fierzë	2.556	10.9
						Komunës Qerret	3.509	15,0
						Komunës Iballë	2.720	11,6
19	Ujësjellësi Tropojë	Sh.a	2	366,05.06.2003	28.168	Bashkisë Bajram Curri	8.460	30,0
						Komunës Margegaj	3.081	10.9
						Komunës Tropojë	5.669	20.1
						Komunës Bujan	3.608	12.8
						Komunës Llugaj	2.371	8.4
						Komunës Fierzë	2.917	10,4
						Komunës Bytyç	2.062	7,3
20	Ujësjellës Gramsh	Sh.a	3	251.24.04.2003	30.576	Bashkisë Gramsh	14.542	47.6
						Komunës Kushovë	1.230	4.0
						Komunës Pishaj	7.873	25.7
						Komunës Tunjë	2.228	7.3
						Komunës Sult	1.455	4.8

						Komunës Kodovjal	3.248	10.6
21	Ujësjellësi Kukës	Sh.a	9	366,05.06.2003	31.770	Bashkisë Kukës	21.308	67.1
						Komunës Shtiqën	4.033	12.7
						Komunës Bicaj	6.429	20.2
22	Ujësjellësi Tepelenë	Sh.a	14	643,18.09.2003	34.050	Bashkia Tepelenë	8.208	24.1
						Bashkia Memaliaj	7.399	21.7
						Komunës Qendër Tepelen	6.799	20.0
						Komunës Qendër Memaliaj	3.546	10.4
						Komunës Qesarat	2.665	7.8
						Komunës Krahës	3.910	11.5
						Komunës Kurvelesh	1.523	4.5
23	Ujësjellësi Gjirokastër Qytet	Sh.a	18	366,05.06.2003	37.241	Bashkisë Gjirokastër	35.241	94.6
						Kom. Lunxhëri (pjesërisht	2.000	5.4
24	Ujësjellës Kanalizime Mallakastër	Sh.a	11	643,18.09.2003	38.090	Bashkisë Ballsh	11.698	30.7
						Komunës Qendër Dukas	8.811	23.1
						Komunës Aranitas	4.474	11.7
						Komunës Hekal	4.776	12.5
						Komunës Kute	3.426	9.0
						Komuna Fratar	4.905	12.9
25	Ujësjellës Kanalizime Lezhë	Sh.a	13	366,05.06.2003	47.565	Bashkisë Lezhë	26.156	55,0
						Komunës Shëngjin	10.864	22,8
						Komunës Balldre	10.545	22,2
26	Ujësjellësi Kuçovë	Sh.a	5	251,24.04.2003	49.034	Bashkia Kuçovë	30.303	61.8
						Komunës Perondi	8.098	16,5
						Komunës Kozare	10.633	21,7
27	Ujësjellës Kanalizime Peshkopi	Sh.a	8	251,24.04.2003	50.184	Bashkisë Peshkopi	18.445	36.8
						Komunës Kala e Dodës	3.340	6,7
						Komunës Sllovë	3.435	6.8
						Komunës Fushë Cidhen	4.027	8.0
						Komunës Luzni	3.736	7,4
						Komunës Kastriot	7.698	15.3
						Komunës Qendër Tomin	9.503	18.9
28	Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe	Sh.a	6	251.24.04.2003	54.418	Bashkisë Koplik	11.001	20.2
						Komunës Shkrel	5.998	11.0
						Komunës Qendër Koplik	5.881	10.8
						Komunës Kastrat	12.104	22.2
						Komunës Kelmend	6.669	12,3
						Komunës Gruemirë	12.765	23.5
29	Ujësjellës Kanalizime Pogradec	Sh.a	10	366.05.06.2003	55.755	Bashkisë Pogradec	39.646	71.1
						Komunës Buçimas	16.109	28.9
30	Ujësjellës Patos	Sh.a	17	366.05.06.2003	59.714	Bashkisë Patos	32.499	54.4
						Komunës Cakran	16.183	27.1
						Komunës Portëz	11.032	18.5
31	Ujësjellësi Shkodër	Sh.a	4	366.05.06.2003	68,770	Komunës Bërdicë	9.101	13.2

	Fshat					Komunës Velipojë	8 .403	12.2
						Komunës Hajmel	6.319	9.2
						Komunës Gur i Zi	11.591	16.9
						Komunës Ana e Malit	5.847	8.5
						Komunës Shalë	5.044	7.3
						Komunës Rrethinat	22.465	32,7
32	Ujësjellësi Kanalizime Kurbin	Sh.a			64.549	Bashkisë Lac	29.891	46.3
						Bashkisë Mamurras	21.852	33.9
						Komunës Milot	12.806	19,8
33	Ujësjellës Kanalizime Sarandë	Sh.a	17	643,18.09.2003	61.942	Bashkisë Sarandë	39.192	63.3
						Komunës Dhivër	6.255	10.1
						Komunës Aliko	8.563	13.8
						Komunës Mesopotam	6.132	9.9
						Komunës Finiq (F.Vrion)	1.800	2.9
34	Ujësjellësi Korçë Fshat	Sh.a	9	643,18.09.2003	86.681	Bashkisë Maliq	8.075	9,3
						Komunës Drenovë	10.920	12,6
						Komunës Voskop	6.150	7.1
						Komunës Qendër Bulgarec	13.644	15.7
						Komunës Pojan	17.145	19.8
						Komunës Progër	6.041	7.0
						Komunës Vreshtas	10.391	12,0
						Komunës Libonik	14.315	16.5
35	Ujësjellësi Berat	Sh.a	1	366,05.06.2003	84.257	Bashkisë Berat	63.724	75.6
						Komunës Vërtop	7.211	8.6
						Komunës Otllak	13.322	15.8
36	Ujësjellës Kanalizime Korçe	Sh.a	19	366.05.06.2003	86.040	Bashkisë Korçe	86.040	100.0
37	Ujësjellës Kanalizime Kavajë	Sh.a	12	643,18.09.2003	91.848	Bashkisë Kavajë	38.291	41.7
						Komunës Synej	10.087	11.0
						Komunës Golem	11.241	12.2
						Komunës Helmës	4.548	5.0
						Komunës Lekaj	9.367	10.2
						Komunës Luz i Vogël	9.740	10.6
						Komunës Kryevidh	8.574	9.3
38	Ujësjellësi Lushnjë Fshat	Sh.a	12	366,05.06.2003	102.925	Komunës Tërbuf	14.830	14.4
						Komunës Kolonjë	8.145	7.9
						Komunës Libofsh/Fier	10.303	10.0
						Komunës Dushk	10.928	10.6
						Komunës Fier Shegan	8.843	8.6
						Komunës Allkaj	5.978	5.8
						Komunës Bubullime	6.974	6.8
						Komunës Krutje	10.029	9,7
						Komunës Poshnje/Berat	9.974	9.7
						Komunës Gradisht	10.501	10.2
						Komunës Remas	6.420	6.2

39	Ujësjellësi Kanalizime Shkodër	Sh.a	14	251.24.04.2003	112.783	Bashkisë Shkoder	112.783	100.0
40	Ujësjellësi Elbasan Fshat	Sh.a	5	366,05.06.2003	141.544	Bashkisë Cerrik	14.620	10,3
						Bashkisë Belsh	13.955	9.9
						Komunës Grekan	4.901	3,5
						Komunës Gostimë	12.118	8,6
						Komunës Shalës	6.951	4.9
						Komunës Kajan	6.268	4,4
						Komunës Rrasë	2.235	1,6
						Komunës Fierzë	3.742	2.6
						Komunës Papër	8.916	6.3
						Komunës Gjergjan	7.519	5.3
						Komunës Mollas	7.376	5.2
						Komunës Bradashesh	12.539	8.9
						Komunës Gracen	2.527	1,8
						Komunës Gjinar	4.809	3.4
						Komunës Zavalinë	2.104	1,5
						Komunës Labinot Fushë	6.010	4,2
						Komunës Lahinot-Mal	5.450	3,9
						Komunës Shirgjan	9.327	6.6
						Komunës Shushicë	10.177	7.2
41	Ujësjellës Elbasan Qytet	Sh.p.k			131.643	Bashkisë Elbasan	124.643	94,7
						Komunës Bradashesh (pjes	7.000	5,3

42	Ujësjellës Vlorë	Sh. a	16	251,24.04.2003	182.296	Bashkisë Vlorë	128.744	70.6
						Bashkisë Himarë	11.613	6.4
						Komunës Shushicë	9.114	5.0
						Komunës Armen	7.772	4,3
						Komunës Kote	7.343	4.0
						Komunës Qendër	17.710	9,7
43	Ujësjellës Kanalizime Fier	Sh.a	13	643,18.09.2003	158.648	Bashkisë Fier	84.125	53,0
						Bashkisë Roskovec	8.491	5.4
						Komunës Topojë, Seman	7.375	4,6
						Komunës Dermenas	12.070	7,6
						Komunës Levan	16.709	10,5
						Komunës Frakull	10.040	6.3
						Komunës Qendër	11.801	7,4
						Komunës Kuman	8.037	5,1
44	Ujësjellës Gjirokastër fshat	Nderm.			41.885	Komunës Lunxheri	5.216	12,5
						Komunës Qender Libohov	2.930	7,0
						Komunës Lazarat	3.364	8.0
						Komunës Cepo	4.538	10,8
						Komunës Antigone	1.807	4.3
						Komunës Odrie	1.608	3.8
						Komunës Picar	2.118	5.1
						Komunës Zagori	1.316	3,1

						Komunës Dropull i Sipërm	9.590	22.9
						Komunës Dropull i Poshtë	9.398	22.4

45	Ujësjellësi Kanalizime Tiranë	Sh.a	15	366,05.06.2003643 ,18.09.2003	836.064	Bashkisë Tiranë	606.437	72,5
						Bashkisë Kamëz	85.123	10.2
						Bashkisë Vorë	11.500	1.4
						Komunës Bërzhitë	5.639	0,7
						Komunës Shëngjergj	3.475	0,4
						Komunës Prezë	3.500	0,4
						Komunës Petrelë	6.389	0.8
						Komunës Dajt	10.589	1,3
						Komunës Baldushk	5.424	0,6
						Komunës Paskuqan	36.710	4,4
						Komunës Zall Herr	9.895	1.2
						Komunës Kashar	19.412	2,3
						Komunës Farkë	10.797	1,3
						Komunës Krrabë	3.053	0.4
						Komunës Bërxullë	9.094	1.1
						Komunës Vaqarr	9.027	1.1
46	Ujësjellës Kanalizime Delvinë	Sh.a	3	366,05.06.2003	15.444	Bashkisë Delvinë	13.944	90.3
						K.Mesopotam (F. Bistrice)	1.500	9.7
47	Ujësjellësi Kanalizime Durrës	Sh.a	10	643,18.09.2003	358.498	Bashkisë Durrës	196.075	54,7
						Bashkisë Shijak	12.799	3,6
						Bashkisë Vore	7.000	2.0
						Bashkisë Sukth	24.304	6,8
						Bashkisë Manëz	9.031	2.5
						Komunës Thumanë	16.703	4,7
						Komunës Ishëm	3.580	1,0
						Komunës Xhafzotaj	16.123	4,5
						Komunës Rrashbull	25.841	7.2
						Komunës Katund i Ri	15.397	4.3
						Komunës Bubq	7.882	2.2
						Komunës Prerë	2.849	0,8
						Komunës Fush-Kuqe	8.440	2,4
						Komunës Maminas	6.633	1.9
						Komunës Gjepalaj	5.841	1,6

LIDHJA 2

Detyrimet financiare të prapambetura të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve deri më 31.08.2007.

nr	Emërtimi i ndërmarrjes	Sig. 000/leke	Tatimet 000/leke	ARMO 000/leke	Energji 000/leke	Alpetrol sh.a	Totali i detyrimit
1	sh.a ujesj. kanaliz. Kraste	552.00	31.00	-	171.00		754.00
2	“ “ Selenice		-		2.79700		2.797.00
3	“ “ Rubik	-	-	-			-
4	“ “ Bilisht	-	3,98200		1.43200		5.414.00

5	“	“	Orikum				1.167.00		1.167.00
6	“	“	Poliçan	9.530,00	5.563.00	-	1.668.00		16,761.00
7	“	“	Përmet	1,413.00	-	-	1.824.00		3.237.00
8	“	“	Has	4.293.00	2,521.00	-	1.683.00		8.497.00
9	“	“	Peqin	1.274.00	-	-	1.381.00		2,655.00
10	“	“	Mirdite	3.614.00	2.075.00	-	1.964.00		7,653.00
11	“	“	Bulqizë	7.916.00	4.329.00	-	853,00		13.098.00
12	“	“	Librazhd			-	129.00		129.00
13	“	“	Kruje	1.965.00	9.882.00	-	52.00		11,899.00
14	“	“	Skrapar	-	-	-	1.87700		1,877.00
15	“	“	Rrogozhine	-	-	-	1.345.00		1,345.00
16	“	“	Ura vajgurore	-	-	-	1.856.00		1,856.00
17	“	“	Mat	9.093.00	13.328.00	-	-		22,421.00
18	“	“	Puke	4.543.00	103.00	-	44.00		4.690.00
19	“	“	Tropojë	1.499.00	-	-	3.917.00		5,416.00
20	“	“	Gramsh	1.575.00	-		156.00		1.731.00
21	“	“	Kukës	1.394.00	30.267.00	-	-		31,661.00
22	“	“	Tepelene	-	-	-	4.505.00		4,505.00
23	sh.a ujesj. kanaliz. Gjirokastër qytet			9,559.00	-	-	1.500.00		11.059.00
24	“	“	Mallakastër	5.323.00	335.00	122.649.00	1.413.00		129.720.00
25	“	“	Lezhe	-	-	.	12,118.00		12,118.00
26	“	“	Kuçove	74.560.00	1.729.00		5.558.00		81,847.00
27	“	“	Peshkopi	-		-	1.792.00		1.792.00
28	“	“	Malësi e Madhe	7,500.00	-	-	-		7,500.00

29	“	“	Pogradec	-	-	-	-		-
30	“	“	Patos	24.000.00	-	4.000.00	22.796.00	288.000.00	338,796.00
31	“	“	Shkodër fshat	5,326.00	-	-	2.945.00		8,271.00
32	“	“	Kurbin	6,558.00	12.006.00	-	15,457.00		34,021.00
33	“	“	Sarande	-	-	-	8.802.00		8,802.00
34	“	“	Korçe fshat	7,899.00	4,885.00	-	2.237.00		15,021.00
35	“	“	Berat	27,899.00	53,216.00	-	1.010.00		82,125.00
36	“	“	Korçe qytet	-	-	-	-		.
37	“	“	Kavajë	-	-	-	6.450.00		6,450.00
38	“	“	Lushnjë fshat	18,595.00	-	-	4,361.00		22,956.00
39	“	“	Shkodër qytet	68,217.00	88,324.00		29,840.00		186,381.00
40	“	“	Elbasan fshat	8,285.00	.	.	22.672.00		30,957.00
41	shpk ujes.kanaliz. Elbasan qytet			27,935.00	-	.	-		27,935.00
42	sha ujësjellës Vlore			-	-	-	31.349.00		31,349.00
43	sh.a ujesj. Kanaliz. Fier			3,049.00	.	-	32.756.00		35,805.00
44	Nd. ujësjellësit Gjirokastër fshat			3,096.00	-	-	1.202.00		4,298.00
45	sh.a ujesj. kanalizime Tirane			68,442.00	-	-	-		68,442.00
46	Delvine			-	-	-	3.098.00	-	3,098.00
47	“	“	Durrës	-	-	-	109.408.00	-	109,408.00
	Shuma			414,904.00	232,576.00	126,649.00	345,585.00	288,000.00	1,407,714.00

VENDIM
Nr. 63, datë 27.1.2016

PËR RIORGANIZIMIN E OPERATORËVE QË OFROJNË SHËRBIMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIN, LARGIMIN DHE TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 213 e vijues të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të shkronjave "a" e "b", të nënndarjes I, të pikës 3, të nenit 10, dhe të pikës 3, të nenit 70 e vijues të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
RIORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

1. Riorganizimin e të gjitha shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së re administrative-territoriale, në përputhje me ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

2. Të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura organizohen si shoqëri aksionare, sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

3. Bashkive u transferohen aksionet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., aktuale, në pronësi të ish-njësive të qeverisjes vendore të shkrira, sipas ndarjes së re administrative-territoriale. Bashkitë ndjekin procedurat e kalimit të aksioneve në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Në ato bashki, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, bashkia, brenda datës 31 dhjetor 2016, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrativo-territoriale.

5. Bashkitë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit, si dhe çdo të drejtë /detyrim që rrjedh prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, shoqërive të ujësjellës- kanalizimeve dhe ish-njësive të qeverisjes vendore me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me shoqëritë kontraktuese.

6. Në rastet kur në dy ose më shumë bashki ekziston vullneti i përbashkët për krijimin e një shoqërie të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., të përbashkët, në bazë të nevojave për këtë bashkim e të studimit përkatës, ato do të mbështeten me investime nga qeverisja qendrore.

7. Në rastet kur një shoqëri e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., ekzistuese, mbulon me shërbim më shumë se një bashki apo në rastin e parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, organet themeluese të shoqërisë përbëhen nga përfaqësuesit e bashkive përkatëse, pesha e vendimmarrjes së të cilëve është në raport të drejtë me përqindjen e aksioneve që disponon secila bashki. Këshillat bashkiakë përkatës bëjnë miratimin e përqindjeve takuese të aksioneve sipas pikës 3, të këtij vendimi, dhe organet e shoqërisë bëjnë regjistrimin e aksioneve sipas legjislacionit në fuqi.

8. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., kanë detyrimin të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve dhe prefektit të qarkut për të gjitha të dhënat dhe informacionet sipas formateve e afateve të përcaktuara prej saj. Formatet e dhënies së informacionit miratohen me udhëzime të ministrit të linjës. Gjithashtu, shoqëritë kanë detyrimin për të raportuar për pjesën e tyre të të dhënave që duhet të hidhen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

9. Ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve, në planifikimin e fondeve për investime nga buxheti i shtetit dhe institucionet financiare ndërkombëtare udhëhiqet nga dokumentet strategjike sektoriale të miratuara, si dhe nga performanca e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a.

10. Stafi menaxherial dhe operacional i shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., i nënshtrohet procesit të trajnimit dhe certifikimit sipas programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve.

KREU II

DISPOZITA KALIMTARE E TË FUNDIT

1. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., organizohen në përputhje me statutin tip, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha bashkitë dhe shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës- kanalizimeve, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", bëjnë zgjerimin dhe zvogëlimin e kapitalit, sipas rastit, duke shtuar ose duke hequr kapitalet e sistemeve publike të ujësjellës-kanalizimeve që i bashkohen ose që i hiqen.

3. Të gjitha shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., brenda 3 (tre) muajve nga riorganizimi, aplikojnë për t'u pajisur me licencë për kategoritë përkatëse të shërbimeve dhe për rishikim të tarifave pranë ERRU-së.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 12.9.2007, "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore", nr. 677, datë 3.10.2007, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 642, datë 11.10.2005, të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore"", nr. 678, datë 3.10.2007, "Për një shtesë në vendimin nr. 271, datë 9.5.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore"", shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Enti Rregullator i Ujit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, njësitë e qeverisjes vendore, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1 STATUTI TIP I SHOQËRIVE AKSIONARE, SHTETËRORE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE"_"

Neni 1

Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë/bashkive , aksionarë të saj.

2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet Ujësjellës-Kanalizime sh.a., .

3. Selia e shoqërisë është në adresën .

Neni 2

Objekti

1. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", është:

a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;

c)Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;

ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

2. Shoqëria duhet të realizojë çdolloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën ___ lekë. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar tërësisht.

2. Kontributet e aksionarit janë kontribute në natyrë, të cilat janë vlerësuar përpara regjistrimit të shoqërisë nga një ekspert i caktuar nga gjykata kompetente, vlerësim i cili është materializuar në një raport vlerësimi që përmban një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë.

Neni 4

Aksionet e shoqërisë

1. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore.

2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.

3. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga një kuotë me vlerë____ lekë dhe zotërohet në masën____% nga aksionari.

Neni 5

Organet e shoqërisë

1. Organet e shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve sh.a., janë:

a) Asambleja e Përgjithshme;

b) Këshilli i Administrimit.

Neni 6

Asambleja e Përgjithshme (AP)

1. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga kryetari i bashkisë përkatëse, i cili merr vendime brenda kompetencave të parashikuara nga ligji për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

2. Nëse shoqëria aksionare mbulon me shërbim më shumë se një bashki, Asambleja përbëhet nga kryetarët e bashkive përkatëse. Pesha e votës e secilit prej anëtarëve të Asamblesë është në përpjesëtim me përqindjen e aksioneve, sipas ndarjes territoriale-administrative.

3. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga kryetari i AP-së, Këshilli i Administrimit, administratori i shoqërisë. Ajo mund të thirret, gjithashtu, nga:

a) eksperti kontabël i autorizuar;

b) nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent;

c) me kërkesë të aksionarit të vetëm të shoqërisë.

4. Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

5. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore dhe që i dërgohet me anë të një njoftimi me letër rekomande çdo anëtari të Asamblesë së Përgjithshme me shpenzimet e shoqërisë.

6. Në njoftimin, që duhet t'i shkojë çdo anëtari të Asamblesë së Përgjithshme apo të njihet prej çdo anëtari, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, përcaktohen dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës.

7. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme që thirret në mënyrë të parregullt është absolutisht i pavlefshëm. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas procedurës së kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht nga parregullsia.

Neni 7

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:

a) Përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore;

b) Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;

c) Miraton projektplanin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit;

ç) Emëron dhe shkarkon ekspertët kontabël të autorizuar;

d) Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

dh) Çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe në statut.

2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Neni 8

Kryetari dhe sekretari i Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga kryetari i bashkisë përkatëse. Në rast se AP-ja përbëhet nga më shumë se një aksionar, aksionarët zgjedhin kryetarin e AP-së.

2. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme asistohet nga një sekretar i emëruar nga AP-ja, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon kryetari i AP-së.

3. Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e AP-së jepen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emrat e drejtuesit e të sekretarit të AP-së, kuorumi i arritur dhe numri i aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e AP-së, një përmbledhje e diskutimeve, teksti i vendimeve të kaluara për votim dhe rezultati i votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit e AP-së në mbledhje, si dhe nga sekretari.

Neni 9

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet nga personi i cili bën lajmërimin.

2. Në rast se mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së saj nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 10

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;

ç) Investimet;

d) Riorganizimin e shoqërisë.

2. Në rastin kur AP-ja ka më shumë se një aksionar, në rastin e çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 30% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe kryetari i Asamblesë së Përgjithshme, me përjashtim të rastit kur AP-ja vendos për shkarkimin e administratorëve e të anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ku nuk kërkohet ky kuorum.

3. Kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, sipas pikës 4, të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm në mbledhje më shumë se 50% e anëtarëve të saj, me kusht që pjesë e saj të jetë dhe kryetari i Asamblesë së Përgjithshme.

4. Asambleja e Përgjithshme merr vendim me 3/4 (tre të katërtat) e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 3, të këtij neni, lidhur me:

a) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;

b) Riorganizimin e shoqërisë.

5. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në ligj dhe në pikën 4, të këtij neni, çdo vendim tjetër i Asamblesë së Përgjithshme merret me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni.

Neni 11

Këshilli i Administrimit (KA)

1. Këshilli i Administrimit është organi i vetëm që ushtron funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë.

2. Kohëzgjatja e funksionit të Këshillit të Administrimit është 3 vjet. Mandati i KA-së ndërpritet në rast konstatimi të mospërmbushjes së objektivave të vendosur në kontratën e performancës midis AP-së dhe anëtarëve të KA-së, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit të Administrimit mbeten vakant, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e mbetjes vakant të vendit. Anëtari i Këshillit të Administrimit i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër përfundon mandatin e paraardhësit.

4. Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1 (një) Këshill Administrimi të shoqërive aksionare që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Këshilli i Administrimit zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata ushtrojnë këtë funksion për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm. Këshilli i Administrimit mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën, sipas legjislacionit në fuqi

6. Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Këshillit të Administrimit drejtohen nga zëvendës-kryetari.

Neni 12

Përbërja e Këshillit të Administrimit

1. Anëtarët e Këshillit Administrimit janë persona fizikë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 3-vjeçar dhe mund të rizgjidhen. Ata duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jenë me profesion inxhinierë të fushës, ekonomist ose jurist.

- Të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë nen është absolutisht i pavlefshëm.

2. Këshilli Administrimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 1 (një) prej të cilëve është administratori dhe 2 (dy) janë persona të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri.

3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznesplanet e shoqërisë.

4. Në rastin e vendeve vakante, që krijohen me vdekjen apo dorëheqjen e një apo disa anëtarëve të Këshillit të Administrimit, kur numri i anëtarëve të këtij këshilli ka zbritur nën minimumin ligjor, administratorët duhet të thërrasin urgjentisht mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Neni 13

Kompetencat e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit ushtron, njëko-hësisht, funksione administrimi e mbikë-qyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë dhe i jep administratorit autorizimin për kryerjen e veprimeve që nuk mund të kryhen prej tij pa autorizimin e Këshillit të Administrimit.

2. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

3. Këshilli i administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) Të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

c) Të gjykojë paraprakisht biznesplanin e shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

ç) Të përgatitë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

d) Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

dh) Të respektojë standardet e kontabilitetit;

e) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

ë) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga

administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit për t'iu paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit të Administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

f) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Administratorëve. Raporti i Këshillit të Administrimit, përmendur në shkronjën "ë" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

g) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

gj) Të miratojë paraprakisht biznesplanin e paraqitur nga administratori dhe t'ia paraqesë për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme.

4. Këshilli i Administrimit ka të drejtë t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme:

a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë;

b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së administratorëve të shoqërisë;

c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;

ç) Marrjen e huave afatmesme e afatgjata;

d) Për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i Administrimit mblidhet jo më pak se një herë në muaj muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit.

2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Administrimit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit të Administrimit i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin e Administrimit duke i përcaktuar rendin e ditës.

4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.

5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit të Administrimit duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit të Administrimit zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.

6. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.

7. Vendimet e Këshillit të Administrimit pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit të Administrimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit të Administrimit duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

Neni 15

Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë KA-në ose një anëtar të saj, duke vërtetuar mospërmbushjen e objektivave të vendosur në kontratën midis palëve, me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 16

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme: a) Me mbarimin e mandatit të administratorit.

b) Me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre.

Neni 17

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.

2. Shoqëria njeh, gjithashtu, dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit të Administrimit, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Administrimit për probleme të shoqërisë.

Neni 18

Administratori i shoqërisë

1. Administratori i shoqërisë është person fizik, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të shoqërisë. Për t'u zgjedhur administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e administrimit të biznesit, sipas profilit që do të emërohet.

b) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij, nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe i certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

c) Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate pozitive të punës, të vërtetuar me referenca nga punëdhënësit e mëparshëm.

3. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.

4. Një person nuk mund të emërohet administrator në më shumë se një shoqëri.

5. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar.

6. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për administratorin sipas kritereve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe administratorit.

7. Administratori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

a) Menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

b) Harton planbizneset e shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Administrimit.

c) Harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtori/departament teknik dhe një drejtori/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti.

ç) I paraqet Këshillit të Administrimit një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit të Administrimit llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.

d) Përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj.

dh) Paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.

e) Raporton përpara Këshillit të Administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.

ë) Lidh kontrata në emër të shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtorëve të tjerë.

f) Siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë.

g) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë.

gj) Organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë.

h) Krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.

i) Kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi.

j) I paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit të Administrimit, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet.

k) Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Administrimit.

l) Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

Neni 19

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik

1. Drejtori teknik zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kritereve minimale:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi,
biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme,

b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet.

Në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri
hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, meka-nike apo disiplina të ngjashme.

c) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

2. Drejtori teknik ka këto kompetenca:

a) Bën studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të
konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara.

b) Bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.

c) Është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës.

ç) Administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesorë, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe pajisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale).

d) Është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri te konsu-matori.

dh) Garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

e) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Drejtorin e Përgjithshëm

Neni 20

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit tregtar

1. Drejtori tregtar zgjidhet nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas kritereve minimale:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master

shkencor", në shkencat ekonomike, në degët financë/administrim biznesi.

b) Të zotërojë certifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë.

2. Drejtori tregtar ka këto kompetenca:

a) Siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të shoqërisë.

b) Siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj.

c) Harton planbuxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv.

ç) Është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente të cilat ia paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit të Administrimit për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e
administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit.

d) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

dh) Ushtron kontrolle periodike mbi
veprimtarinë ekonomike-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës.

e) Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga Ministria e Financave.

ë) Siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.

f) Siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të shoqërisë.

g) Çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 21

Detyrimi i besnikërisë

1. Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:

a) Të kryejë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;

b) Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;

c) Të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;

ç) Të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;

d) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratorët, që veprojnë në kundër-shtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Neni 22

Shkarkimi i administratorit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërmbushjes së objektivave të kontratës midis palëve.

2. Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë shkarkimin e administratorit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tij, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

Neni 23

Përfundimi i mandatit të administratorit

Mandati i administratorit të shoqërisë
përfundon me konstatimin e atyre rrethanave të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij.

Neni 24

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga

Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 25

Ushtrimi kontabël

Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 26

Inventari - llogaritë vjetore

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.

2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Neni 27

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

3. Fitimet e akumuluara nga shoqëria, pas arritjes së rezervës 10 për qind, vlera e të cilave e kalon nevojën për investime dhe zhvillimin e shoqërisë, do t'i kalojnë dhe do të përdoren nga Bashkia. Fitimet e akumuluara brenda këtij kufiri do të përdoren nga shoqëria sipas nevojave të saj për investime kapitale.

Neni 28

Procedura e bashkimit të shoqërisë me operatorë të tjerë

Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Të jetë të licencuar nga Enti Rregullator i Ujit.

b) Të ketë vlerësuar dhe përditësuar inventarin e aseteve e të likuiditeteve të tyre.

c) Të jetë miratuar me vendim përkatës të Këshillit Bashkiak.

Neni 29

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 30

Dispozita të kalimtare

Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA AKSIONARE "UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN"
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

Nr4563Prot

Elbasan, më 09.07.2018

VENDIM

Nr604 datë 09.07.2018

Për

"Ndarjen e shoqërisë "Ujësjellësi Fshat Elbasan" SHA, në tre shoqëri ekzistuese pritëse"

Në mbështetje të nenit 135, pika 2(h), nenit 214, pika 2 dhe nenit 227 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të VKM Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha, në mbledhjen e saj të datës 09.07.2018,

VENDOSI

1. Të miratojë ndarjen e shoqërisë "Ujësjellësi Fshat Elbasan" SHA, duke ndarë të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë që ndahet, në favor të tre shoqërive ekzistuese pritëse, si më poshtë:

   - "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" SHA, me NIPT – L43121201L, me aksionar të vetëm Bashkia Elbasan
   - SHA "Ujësjellës Kanalizime Cërrik", me NIPT – L63502206Q, me aksionar të vetëm Bashkia Cërrik
   - "Ujësjellës Kanalizime Belsh" SHA, me NIPT – L63215202R, me aksionar të vetëm Bashkia Belsh

2. Te miratoje Marrveshjen e ndarjes se shoqerise, te hartuar nga administratoret e shoqerive respektive.
3. Te miratoje relacionin e administratoreve per ndarjen e shoqerise.
4. Te miratoje raportin e ekspertit kontabel per ndarjen.
5. Ky vendim regjistrohet në regjistrin e veçantë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA PËRGJITHSHME
e përfaqësuar nga

Bashkia Elbasan
Qazim SEJDINI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Elbasan, më datë 08.03.2018

PROJEKTI I MARRËVESHJES SË NDARJES

Ndërmjet

SHOQËRISË
"UJËSJELLËSI FSHAT ELBASAN" SHA
Në cilësinë e shoqërisë që ndahet

dhe

SHOQËRIVE

UJËSJELLËS KANALIZIME BELSH" SHA

SHA "UJËSJELLËS KANALIZIME CËRRIK"

"UJËSJELLËS - KANALIZIME ELBASAN" SHA

Në cilësinë e shoqërive pritëse

Aksioneret e shoqerise "Ujësjellësi Fshat Elbasan" sha kane vendosur që Shoqëria "Ujësjellësi Fshat Elbasan" sha do të ndahet sipas të gjitha modaliteteve ligjore, të cilat parashikohen në nenet 216 – 220 e 227 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Mbi këtë bazë, Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive të cilat marrin pjesë në ndarje e konkretisht: Përfaqësuesi i shoqërisë që ndahet dhe Përfaqësuesit e shoqërive pritëse, po hartojnë një Projekt-Marrëveshje për ndarjen si më poshtë:

1. **Emrat e regjistruar dhe selitë e Shoqërive që marrin pjesë në procesin e ndarjes:**

A. **Shoqëria që ndahet (me poshte do te quhet kontribuese):**

- **Shoqëria "UJËSJELLËSI FSHAT ELBASAN" SHA** e regjistruar ne organin tatimor me NIPT J93112216Q, me seli në adresën Prane Stacionit te Trenit, Elbasan, eshte nje shoqeri aksionere me aksionere Bashkine Cerrik qe zoteron 29% te aksioneve, Bashkine Elbasan qe zoteron 49.1% te aksioneve dhe Bashkine Belesh qe zoteron 21.9% te aksioneve te shoqerise, e përfaqësuar nga Administratori z.Ilir Ropi, dhe me objekt te veprimtarise: *Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirmbajtja e sistemit /eve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe / ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve.* Kapitali i shoqerise eshte 701.835.017 leke.

B. **Shoqëritë pritëse:**

- **Shoqëria "UJËSJELLËS KANALIZIME BELSH" SHA,** e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L63215202R, me seli në adresën Belsh, Qender Rruga 31 Gushti, Elbasan, eshte nje shoqeri aksionare, krijuar nga Bashkia Belsh, e përfaqësuar nga Administratori **z.Endri Pepa**,

dhe me objekt te veprimtarise *: Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura. Mirembajtja e sistemimeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregetar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.*

- **Shoqëria SHA "UJËSJELLËS KANALIZIME CËRRIK",** e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L63502206Q, me selinë adresën Gostime, zona kadastrale 1820, objekti me nr.pasurie148/10, eshte nje shoqeri aksionere krijuar nga Bashkia Cerrik, e përfaqësuar nga Administratori **z.Ervis Calja**, dhe me objekt te veprimtarise *: Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura. Mirembajtja e sistemimeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregetar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.*

- **Shoqëria "UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN" SHA**, e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L43121201L, me seli në adresën Lagjja "Brigada e 17 Sulmuese", Rruga Petraq Popa, Zk.8523, pasuria nr.4/40, Elbasan, eshte nje shoqeri aksionere krijuar nga Bashkia Elbasan, e përfaqësuar nga Administratori **z.Besmir Prifti** dhe me objekt te veprimtarise: *Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirmbajtja e sistemit /eve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe / ose blerja e ujit per plotesimine kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit , largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura dhe shitja e tij. Mirembajtaja e sistemeve te ujerave te ndotura si dhe te impjanteve te pastrimit te tyre.*

2. **<u>Pranimi i palëve për kalimin e pasurive në drejtim të shoqërive të reja:</u>**

Palet e nënshkruara në këtë projekt-marrëveshje ndarje janë dakort që Shoqëria "Ujsjellësi Fshat Elbasan" sha. te ndahet ne tre shoqëri të tjera: "Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha., sha. "Ujësjellës Kanalizime Cërrik", "Ujësjellës Kanalizime Belsh" sha., ndërsa ekzistuesja "Ujsjellësi Fshat Elbasan" sha do te çregjistrohet. Ndarja do te behet duke ndare te gjitha asetet dhe detyrimet (aktivet dhe pasivet) sipas bilancit të ndarjes, të datës 31.03.2018. Në këtë rast në bazë të Nenit 227 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, shoqëria ndarëse, "Ujësjellësi Fshat Elbasan" sha, quhet e prishur.

3. **<u>Shoqëritë pritese:</u>**

Shoqerite pritese jane përfituese të kontributeve, aseteve e detyrimeve sipas bilancit të ndarjes të dates 31.03.2018.

Shoqëritë "Ujësjellës-Kanalizime Elbasan" sha., sha "Ujësjellës Kanalizime Cërrik", "Ujësjellës Kanalizime Belsh" sha hartojne kete projekt per ndarje:

Theksojme se qe nga krijimi i saj deri ne momentin e hartimit te projektit te ndarjes, aktiviteti i shoqerise ka realizuar veprimarine ekonomike te furnizimit me uje, sherbimi i grumbullimit dhe

trajtimit te ujrave te zeza. Aksioneret e kesaj shoqerie kane vendosur qe te realizojne aktivitetin sejcili me vehte, duke trasheguar te gjitha te drejtat e detyrimet sipas bilancit te ndarjes te dates 31.03.2018.

4. **Baza ligjore.**

Ndarja e shoqerise do te behet ne baze te ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Nenet 216 deri 225 e 227.

5. **Drejtimi i ndarjes.**

Në këtë projekt ndarje shoqërie, "Ujësjellësi Fshat Elbasan" sha do të jetë shoqëria që ndahet, si dhe do të jetë shoqëria kontribuese e do të shënohet më poshtë si shoqëria kontribuese, e cila më pas do të prishet.

6. **Motivet dhe qëllimi i ndarjes.**

Aktiviteti i shoqerise shtrihet ne tre bashki te cilat jane larg njera tjetres dhe nje gje e tille shkakton veshtiresi ne administrimin e saj. Po ashtu, edhe burimet e ujit qe furnizohen keto qytete jane larg njeri tjetrit, dhe teknologjia e shfrytëzimit të ujit është krejt e ndryshme. Sejcila nga shoqëritë pritëse do të administrojë ujsjellësat e fshatrave që janë nën juridisionin e tyre.

Qëllimi i ndarjes është organizimi më i mirë dhe drejtimi më me shumë efektivitet i aktivitetit të furnizimit me uje për popullatën e zonave gjeografike që përfshihen në juridiksionin administrativ të Bashkisë Elbasan, Cërik dhe Belsh. Ortaket kane eksperiencen e nevojeshme, klientelen e burimet materiale e financiare per realizimin me sukses te misionit qe kane marrë. Ndarja do te çoje ne ristrukturim te aktivitetit per rritjen e frytshmerise ekonomike, perdorim me efikas i mjeteve dhe burimeve ne fuksion te rritjes se perfitimeve ekonomike, menaxhimi me i mire i burimeve njerezore dhe financiare.

7. **Aktivet dhe pasivet e parashikuara për t'u ndarë.**

Ne kuadrin e ketij operacioni ndarje, parashikohet qe shoqëria "Ujesjellësi Fshat Elbasan" sha ti transferoje (kalojë) shoqërive: "Ujësjellës-Kanalizime Elbasan" sha., sha. "Ujësjellës Kanalizime Cërrik", "Ujësjellës Kanalizime Belsh" sha, tëresinë e elementeve të aktivit dhe të pasivit ashtu si rezultojnë në bilancin e dates 31.03.2018. Elementet e aktivit dhe te pasivit qe do te kalojne nga shoqëria kontribuese tek shoqeritë pritëse, paraqiten në pasqyrën nr.1.

8. **Modalitetet, raportet e ndarjes te kuotave, kushtet e ndarjes.**

Përkundrejt kalimit te aktiveve ne shoqerite pritese, aksioneret e shoqërisë kontribuese që ndahet, "Ujësjellësi Fshat Elbasan" heqin dorë nga vlera e kontributeve të tyre në shoqërinë e vjetër "Ujësjellesi Fshat Elbasan" sha duke vlerësuar kontributet e tyre në shoqeritë pritëse:

-"Ujësjellës - Kanalizime Elbasan" sha.,
- Sha "Ujësjellës Kanalizime Cërrik",
-"Ujësjellës Kanalizime Belsh" sha.

Shoqerite pritëse gëzojnë frutet e kontributit, duke filluar nga data e realizimit te ndarjes me fjale.

Para fillimit të procedurave të ndarjes, kapitali themeltar i shoqërisë "Ujësjellësi Fshat Elbasan" sha është 701.835.017 lekë, i përberë nga 1.000 aksione, me vlerë nominale 701.835,02 lekë.

Para fillimit të procedurave të ndarjes, zotërues të kapitalit të shoqerisë "Ujësjellës Fshat Elbasan" sha janë:

- Bashkia Elbasan, që zotëron 491 aksione ose 49.1 % të kapitalit.

- Bashkia Cërrik, që zoteron 290 aksione ose 29 % të kapitalit.
- Bashkia Belsh, që zotëron 219 aksione ose 21.9 % të kapitalit.

Përfundimisht mbas realizimit të operacionit të ndarjes do të kemi tre shoqëri:

- **Shoqëria "UJËSJELLËS KANALIZIME BELSH" SHA** e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L63215202R, me seli në adresën Belsh, Qender Rruga 31 Gushti, Elbasan. Objekti i shoqerise do te jete*: Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura. Mirembajtja e sistemimeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregetar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.*

  Kapitali i shoqërisë do të jetë 45.434.140 leke i ndarë në 1 aksion me vlerë nominale 45.434.140 lekë/aksion.

  Aksioner i vetëm i shoqërisë do të jetë Bashkia Belsh, që do të zoterojë 100% të kapitalit të shoqerisë.

- **Shoqëria SHA "UJËSJELLËS KANALIZIME CËRRIK",** e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L63502206Q, me selinë adresën Gostime, zona kadastrale 1820, objekti me nr pasurie148/10. Objekti i veprimtarise *: Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura. Mirembajtja e sistemimeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregetar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.*

  Kapitali i shoqerise do te jete 79.086.846 leke i ndare ne 1 aksion me vlere nominale 79.086.846 leke/aksion.

  Aksioner i vetëm i shoqerisë do të jetë Bashkia Cërrik që do të zoterojë 100% te kapitalit te shoqerise.

- **Shoqëria "UJËSJELLËS - KANALIZIME ELBASAN" SHA,** e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L43121201L, me seli në adresën Lagjja Brigada e 17 Sulmuese, Rruga Petraq Popa, Zk 8523, pasuria nr 4/40, Elbasan. Objeki i veprimtarise : *Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirmbajtja e sistemit /eve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe / ose blerja e ujit per plotesimine kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit , largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura dhe shitjae tij .Mirembajtaja e sistemeve te ujerave te ndotura si dhe te impjanteve te pastrimit te tyre.*

  Kapitali i shoqërisë do të jetë 2.145.432.331 leke i ndarë në 1 aksion me vlerë nominale 2.145.432.331 lekë/aksion.

  Aksioner i vetëm i shoqërisë do te jetë Bashkia Elbasan që do të zoterojë 100% të kapitalit të shoqërisë.

Këto shoqëri do te vazhdojne aktivitetin e tyre sipas statutit dhe akt themelimit qe ka sejcila.

Administratorët e shoqërive do të vazhdojnë të jene ata që janë të emeruar aktualisht në sejcilen prej tyre.

9. Data kontabël.

Në aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise të kryera prej shoqërisë nga data 01.05.2018 e deri ne daten e realizimit të ndarjes do te konsiderohen si të kryera nga shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha dhe rregjistimet përkatese kontabel do të merren në librat e saj. Ketu theksojme se shoqerite "Ujësjellës Kanalizime Cërrik",sha dhe "Ujësjellës Kanalizime Belsh" sha, kane filluar aktivitetin e tyre dhe kane marre nepermjet transferimit aktivet neto sipas bilancit te dates 31.10.2016. Ne keto kushte kur data e ndarjes do te jete data 31.03.2018, aktivet dhe pasivet e ketyre shoqerive do te jene sipas bilancit te transferimit dt 31.10.2016, me perjashtim te shoqerise "Ujësjellës Kanalizime Cërrik",sha, e cila do te marre ne pronesi edhe ujsjellesin e Banjes me vlere 8.173.186 leke. Keshtu kapitali i kesaj shoqerie sipas transferimit me date 31.10.2016 eshte 70.913.660 leke . Duke shtuar edhe vleren e ujsjellesit te Banjes, kapitali i saj behet 79.086.846 leke. Ndersa diferenca qe rezulton nga kapitali i shoqerise "Ujësjellësi Fshat Elbasan" sha i dates 31.03.2018 me bilancet e mesiperme do te perbeje kapitalet qe do ti kalojne shoqerise "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha.

10. Të drejtat dhe avantazhe të veçanta

Ky operacion ndarje nuk do te përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.
Ky projekt-marrëveshje ndarje hartohet e nënshkruhet në kushtin e varësisë së miratimit nga Asambleje e Përgjithshme e sejcilës prej shoqërive pjesëmarrëse (shoqërisë që ndahet dhe shoqërive pritëse).

11. Pasojat e ndarjes ndaj punonjësve, etj.

Gjatë procesit te ndarjes, të punësuarit si dhe stafi tjetër nuk do të ketë asnjë cënim në të drejtat e tyre. Konkretisht, të gjithë të punësuarit e shoqërisë që ndahet, u ndanë në mënyrë të barabartë tek sejcila shoqëri pritëse, me të njëjta funksione që kanë patur më parë si dhe me të njëjtat paga.

12. Eksperti kontabel

Emerohet ekspert kontabel per ndarjen e shoqerise zoti Agim Qenani me licence nr 53 date 20.01.2000.

SHOQËRIA QË NDAHET

"UJËSJELLËSI FSHAT ELBASAN" SHA
ADMINISTRATORI
Ilir ROPI

SHOQËRITË PRITËSE

"UJËSJELLËS - KANALIZIME ELBASAN" SHA
ADMINISTRATORI
Besmir PRIFTI

SHA "UJËSJELLËS KANALIZIME CËRRIK"
ADMINISTRATORI
Ervis CALJA

"UJËSJELLËS KANALIZIME BELSH" SHA
ADMINISTRATORI
Endri PEPA

Elbasan, më datë 08.03.2018

RAPORT MBI ECURINE E SHOQERISE

SHOQËRIA
'UJËSJELLËSI FSHAT ELBASAN" SHA
Në cilësinë e shoqërisë që ndahet

Shoqeria tregetare "Ujesjellesi Fshat Elbasan" sha eshte krijuar ne baze te Vendimit te Gjykate Tregetare Tirane Nr 27556 date 10.04.2001, regjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Elbasan me NIPT J93112216Q, me aktivitet *Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirmbajtja e sistemit /eve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe / ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve,* e përfaqësuar nga Administratori z.Ilir Ropi dhe me kapital 701.835.017 leke, me seli në adresën Prane Stacionit te Trenit, Elbasan, eshte nje shoqeri aksionere me aksionere:

- Bashkia Cerrik qe zoteron 29% te aksioneve.
- Bashkia Elbasan qe zoteron 49.1% te aksioneve.
- Bashkia Belesh qe zoteron 21.9% te aksioneve.

Ortaket kane hartuar nje projekt marrveshje sipas se ciles shoqeria "Ujesjelles Fshat Elbasan" sha do te ndahet ne tre shoqeri te tjera qe jane quajtur "Ujesjelles Kanalizime Belesh" sha, "Ujesjelles Kanalizime Cerrik" sha dhe "Ujesjellesi Kanalizime Elbasan" sha. Ndarja do te behet duke ndare te gjitha asetet dhe detyrimet sipas bilancit te ndarjes te dates 31.03.2018. Ne kete rast ne baze te Nenit 227 te Ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per tregetaret e shoqerite tregetare " shoqeria ndarese, "Ujesjelles Fshat Elbasan" sha, quhet e prishur.

1. Shoqerite pritese:

- Shoqëria "UJËSJELLËS KANALIZIME BELSH" SHA, e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L63215202R, me seli në adresën Belsh, Qender Rruga 31 Gushti, Elbasan, eshte nje shoqeri aksionare, krijuar nga Bashkia Belsh, e përfaqësuar nga Administratori z.Endri Pepa, dhe me objekt te veprimtarise : *Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura. Mirembajtja e sistemimeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregetar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.*

- Shoqëria SHA "UJËSJELLËS KANALIZIME CËRRIK", e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L63502206Q, me selinë adresën Gostime, zona kadastrale 1820, objekti me

nr.pasurie148/10, eshte nje shoqeri aksionere krijuar nga Bashkia Cerrik, e përfaqësuar nga Administratori z.Ervis Calja, dhe me objekt te veprimtarise *: Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura. Mirembajtja e sistemimeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregetar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.*

- Shoqëria "UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN" SHA, e regjistruar ne organin tatimor me NIPT L43121201L, me seli në adresën Lagjja "Brigada e 17 Sulmuese", Rruga Petraq Popa, Zk.8523, pasuria nr.4/40, Elbasan, eshte nje shoqeri aksionere krijuar nga Bashkia Elbasan, e përfaqësuar nga Administratori z.Besmir Prifti dhe me objekt te veprimtarise: *Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirmbajtja e sistemit /eve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe / ose blerja e ujit per plotesimine kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit , largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura dhe shitja e tij. Mirembajtaja e sistemeve te ujerave te ndotura si dhe te impjanteve te pastrimit te tyre.*

Persa i perket bazes ligjore theksojme se ndarja e shoqerise do te behet ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 : Per tegetaret e Shoqerite tregetare " Nenet 216 deri 225 e 227 .

Ne kuadrin e ketij operacioni ndarje, parashikohet qe shoqeria "Ujesjelles Fshat Elbasan" sha ti transferoje (kaloje) shoqerive pritese shpk teresine e elementeve te aktivit dhe te pasivit ashtu si rezultojne ne bilancin e dates 31.12.2017. Elementet e aktivit dhe te pasivit qe do te kalojne nga shoqeria "Ujesjelles Fshat Elbasan" sha tek shoqerite pritese "Ujesjelles Kanalizime Belesh" sha, "Ujesjelles Kanalizime Cerrik" sha dhe "Ujesjellesi Kanalizime Elbasan" sha paraqiten ne pasqyren nr.1. Ne kete tabele paraqitet dhe bilanci i perbashket para realizimit te operacionit te ndarjes dhe elementet qe kalojne ne sejcilen prej shoqerive pritese. Vleresimi i elementeve te aktiveve dhe te detyrimeve behet me koston historike mbasi ajo paraqet ne menyre me te besueshme pasurine e shoqerise.

Ketu theksojme se shoqerite "Ujësjellës Kanalizime Cërrik",sha dhe "Ujësjellës Kanalizime Belsh" sha, kane filluar aktivitetin e tyre dhe kane marre nepermjet transferimit aktivet neto sipas bilancit te dates 31.10.2016. Keshtu, data e ndarjes do te jete data 31.03.2018, ndersa aktivet dhe pasivet e ketyre shoqerive do te jene sipas bilancit te transferimit dt 31.10.2016. Nga ana tjeter diferenca qe rezulton nga bilanci i shoqerise "Ujësjellësi Fshat Elbasan" sha i dates 31.03.2018 me bilancet e mesiperme do te perbeje aktivet dhe pasivet qe do ti kalojne shoqerise "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sha.

Shoqerise "Ujësjellës Kanalizime Cërrik", sha do ti shtohet edhe shuma prej 8.173.186 leke qe perfaqeson vleren e ujsjellesit te Banjes qe i kalon kesaj shoqerie.
Ne projektmarrveshje ortaket kane rene dakord qe perkundrejt kalimit te aktiveve ne shoqerite pritese, aksioneret e shoqerise, Bashkia Elbasan, Bashkia Belesh dhe Bashkia Cerrik, heqin dore nga vlera e kontributeve te tyre ne shoqerine e vjeter "Ujesjelles Fshat Elbasan" sha duke vleresuar kontributet e tyre ne shoqerite pritese si vijon :

- Ortaku Bashkia Cerrik ne shoqerine "Ujesjelles Kanalizime Cerrik" sha.
- Bashkia Elbasan ne shoqerine "Ujesjellesi Kanalizime Elbasan" sha.
- Bashkia Belesh ne shoqerine "Ujesjelles Kanalizime Belesh" sha

Keto ishin disa tregues te thjeshte per ecurine e Shoqerise "Ujesjelles Fshat Elbasan" sha.

Per shoqerine "Ujesjelles Fshat Elbasan" sha

Administratori
Ilir Ropi

Per shoqerine "Ujesjelles Kanalizime Belesh" sha

Administratori
Endri Pepa

Per shoqerine "Ujesjelles Kanalizime Cerrik" sha

Administratori
Ervis Calja

Per shoqerine "Ujesjelles Kanalizime Elbasan" sha

Administratori
Besmir Prifti

RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR
PER NDARJEN E SHOQERISE "UJSJELLESI FSHAT ELBASAN"SH.A.

Drejtuar: **Asamblese se Pergjitheshme te Shoqerise**
Keshillit Mbikqyres
Administratorit te shoqerise

Tenderuar zoterinj,

I emeruar nga asambleja e aksionareve te shoqerise "Ujsjelles Fshat Elbasan" sha, per kryerjen e misonit per dhenien e sigurise ne kemi nderin t`ju raportojme ne lidhje me kontrollin e operacionit te ndarjes se shoqerise "Ujesjelles Fshat Elbasan"sha, ne shoqerite "Ujsjelles Kanalizime Belsh" sha, "Ujsjelles Kanalizime Cerrik" sha dhe "Ujsjelles Kanalizime Elbasan" sha.

Përgjegjësia e paleve për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqerise është përgjegjës për përgatitjen e vërtetë dhe të sinqertë të pasqyrave financiare per ndarjen, në përputhje me kuadrin e zbatueshem te raportimit financiar qe perfshin Ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardet Kombëtarete te Kontabilitetit dhe, për kontrollet e brendshme që drejtimi i konsideron te nevojshme për pregatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajne anomali materiale, qoftë nga gabimi apo mashtrimi.

Përfaqësuesit ligjorë dhe financiarë të Shoqërisë "Ujesjelles Fshat"sha Elbasan qe janë angazhuar per te pergatitur pasqyrat financiare te shoqërisë sipas akteve perkatese ligjore ne fuqi.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia e auditit është të formoje një opinion të pavarur mbi këto pasqyra, bazuar në punen e kryer.

Ne kemi kryer angazhimin në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Auditimit. Këto standarde kërkojne që per kryerjen e ketij angazhimi të planifikohen dhe të zbatohen procedura për të dhene siguri të arsyeshme që procedurat e transferimit te aktiveve neto te shoqerise jane kryer ne perputhje te plote me rregullat e zbatueshme dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit dhe legjislacionin ne fuqi.

Angazhimi përfshin procedura për të marre evidence për vlerat dhe paraqitjen e tyre ne pasqyrat financiare mbi bazen e testimeve të dokumentave që mbështesin shifrat dhe informacionet e tjera të pasqyrave financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshire dhe vlerësimin e rrezikut te ekzistences së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Procesverbalet e dorezimit te aktiveve dhe detyrimeve te mbajtura midis Administratoreve te Shoqerise "Ujsjelles Fshat Elbasan" sha, "Ujsjelles Kanalizime Belsh" sha dhe "Ujsjelles Kanalizime Cerrik" sha.

a) Baza Ligjore

- LigjiNr. 115/2014 datë 31.7.2014 Për ndarjen administrative - territorial të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë
- Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9228 dt. 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar
- Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",
- VKM Nr.271,date 08.05.1998 "Per miratimin e statutut TIP te Shoqerive Anonime Shteterore",

b) Afati mbi te cilen shtrihet raporti i dhenies se sigurise se pavarur

Me poshte po paraqesim bazen mbi te cilen eshte vepruar per perfundimin e procesit te transferimit te aktiveve neto te shoqerise

- ✓ *Baza e te dhenave mbi te cilin u mbeshtet procesi i ndarjes se shoqerise jane Pasqyrat Financiare 31.03.2018*
- ✓ *Veprimet /Ngjarjet e ndodhura gjate procesit te ndarjes.*
- ✓ *Vendimet e Asamblese te shoqerise*

c) Identifikimi i paleve ne proces

Shoqeria qe ndahet:

